

TRAJKOVSKA ELIZABETA, inxh. e diplomuar e makinerisë

# **UDHËHEQJA AUTOMATIKE**

PËR VITIN IV – DREJTIMI I MAKINERISË  
TEKNIK I MAKINERISË DHE ENERGJETIKËS

Shkup, 2013

**Botues:**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
Rr. „Mito Haxhivasilev Jasmin”, p.n.  
Shkup

**Recensentë:**

Prof. Dr. Stojçe Deskoski  
Mr. Metodija Popovski, profesor  
Dragan Stojanoviq, inxhinier i diplomuar i makinerisë

**Përkthyes:** Emsale SELMANI

**Lektor:** Ismail MURSELI

**Shtyp:** PROSVETNO DELLO SHA – Shkup

**Shtypshkronja:** NAPREDOK - Tetovë

**Tirazhi:** 54

---

Со решение на Министерот за образование и наука на Република Македонија бр. 22-4335/1 од 29.07.2010 година се одобрува употребата на овој учебник.

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe të Shkencës të Republikës së Maqedonisë numër 22-4335/1 të datës 29.7.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

---

CIP – Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски",  
Скопје

681.5(075.3)

ТРАЈКОВСКА, Елизабета

Автоматско управување: IV год. машинска струка: машинско-енергетски техничар / Елизабета Трајковска. - Скопје: Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010. - 98 стр.: илустр.; 30 см

Библиографија: стр. 98

ISBN 978-608-226-066-2

COBISS.MK-ID 84234250

## PARATHËNIE

Libri "Udhëheqja e automatizuar" është i dedikuar për nxënësit e viti IV-të në shkollat teknike – drejtimi makinerik, për profesionin teknik makineriko-energjetik dhe ka për qëllim që nxënësve t'ju mundësoj zotërim më të lehtë të përbajtjeve të parapara me programin mësimor për këtë lëndë.

Libri është shkruar sipas planit mësimor dhe programit mësimor për lëndën Udhëheqja e automatizuar dhe konceptimi për libër për arsimin fillor dhe të mesëm dhe është i përbërë prej gjashtë temave.

Në hyrje është dhënë vështrimi i zhvillimit dhe rëndësisë së automatizimit dhe aplikimi i sistemeve në udhëheqjen e automatizuar në prodhimtari. Në temën e parë, "Nocionet themelore te sistemet", nxënësit do të njihen me pjesët themelore dhe madhësitë e sistemeve të udhëheqjes së automatizuar, kurse në temën e dytë "Lidhjet themelore te sistemet" janë dhënë lidhjet themelore te sistemet dhe funksionet e tyre përcjellëse. Në temën e tretë, "Struktura e sistemeve të rregullimit", nxënësit do të njihen me sistemet e rregullimeve, pjesët dhe madhësitë e tyre, si dhe me format konstruktive të organeve ekzekutive racionale të sistemeve të rregullimit. Në temën e katërt "Rregullimi i madhësive të procesit", është dhënë rregullimi i madhësive të cilët janë të rëndësishme për procesin, kurse në temën e pestë "Rregullimin e instalimeve" është shpjeguar rregullimi tek instalimet: kazanët dhe instalimet e kazanit, turbinave, pompave dhe kompresorëve. Në temën gjashtë "Automatizimi në sistemet e rregullimit" është shpjeguar kontrollimi automatik dhe administrimi automatik i proceseve.

Duke marrë parasysh atë që teknikët makinerik-energjetik në punën e tyre do të ballafaqohen me probleme praktike, të gjitha nocionet dhe proceset në sistemet e administrimit dhe rregullimit në këtë libër janë shpjeguar nëpërmjet shembujve konkret nga praktika. Për zotërim më të lehtë të materialit në fund të çdo teme është dhënë përbledhje e shkurtër, kurse gjithashtu libri përmban pyetje dhe detyra që nxënësit do t'i ndihmoj për të parashtruar vetëpyetje dhe verifikim të njojurive të arritura.

E shfrytëzoj këtë mundësi që t'ju falënderoj recensemtëve Profesor dr. Stojçe Deskovski, mr. Metodija Popovski dhe Dragan Stojanoviç për kontributin e dhënë dhe të gjitha sugjerimet e dobishme që i dhanë përpunimin më kualitativ të librit.

Që më parë u jam mirënjohëse nxënësve dhe profesorëve të cilët do ta shfrytëzojnë librin dhe me propozimet dhe sugjerimet e tyre do të ndihmojnë në shmangien e lëshimeve eventuale në botimet e ardhshme.

Nga autorja



## HYRJE

Njeriu qysh prej kohëve më të lashta ka synuar që të lirohet prej punës së rëndë fizike. Kishte dëshirë të përhershme ta përsosë punën e tij dhe fuqinë e muskujve të tij, ta zëvendësoj në fillim me makina mekanike të thjeshta, kurse më vonë me gjithnjë e më të ndërlikuara. Kjo ka sjell deri te zbulimet e shumta të cilat shumë kanë ndikuar në zhvillimin e njerëzimit. Me zbulimin e makinave të avullit, elektrike dhe të tjera e njeriut në të. Me aplikimin e mjeteve mekanike në prodhim, puna e njeriut ishte zvogëluar dhe është futur mekanizimi. Domethënë, me aplikimin e mekanizmit në procesin e prodhimit njeriu pushoj të jetë burim themelor i energjisë, përkatësisht zbatues fizik i punë së caktuar. Atë rol e mori makina e cila u bë ndihmëse e njeriut.

Mekanizimi mundëson zmadhimin e prodhimit në të gjitha fushat e prodhimit me çka shumë u ndryshua mënyra dhe kushtet e jetës së njeriut.

Me kohë njeriu vazhdimisht i ka përsosur mjetet ekzistuese dhe ka zhvilluar mjete të reja për mekanizim. Kështu ka ardhur deri te shkalla më e lartë e mekanizmit e cila quhet automatizim. Me këtë janë krijuar kushte për prodhim të shpejtë dhe masiv të zhvillimit të proceseve në prodhim pa pjesëmarrjen e njeriut si zbatues i drejtpërdrejtë. Me aplikimin e automatizimit puna e njeriut në procesin e prodhimit edhe më tepër zvogëlohet.

Fillimet e para të udhëheqjes së automatizuar datojnë që para erës sonë, kurse emri vjen prej fjalës greke "automates" që do të thotë ajo që lëviz vetë. Teoria dhe zbatimi i udhëheqjes së automatizuar ka filluar intensivisht të zhvillohet gjatë Luftës së Dytë botërore dhe deri më sot ende zhvillohet.

Mjetet për punë me të cilat zvogëlohet puna mendore dhe fizike në procesin e prodhimit dhe nëpërmjet kësaj realizohet produktivitet i madh, ekonomikshmëri, siguri, saktësi dhe kualitet i prodhimit me pajisje automatike ose sisteme automatike.

Sot ekzistojnë fabrika ku krejt prodhimi zhvillohet në mënyrë plotësisht automatike dhe në uzinat e tyre nuk ka asnjë njeri. Do të thotë sistemet sigurojnë procese të përcaktuara me operacione paraprakisht të dhëna që zhvillohen në mënyrë të pavarur pa pjesëmarrjen e njeriut. Njeriu i nënshtrohet lodhjes dhe dekoncentrimit që ndikon mbi prodhimin dhe sigurimin e procesit prodhues. Me zbatimin e udhëheqjes automatike ajo është shmangur. Njeriu në proceset e këtilla është organizues i punës dhe vetëm e kontrollon procesin automatik.

Me instalimin e udhëheqjes automatike proceset zhvillohen më shpejtë, më lehtë, më efikas, makinat punojnë në mënyrë më të stabilizuar dhe shmangjet e tyre janë në kufij të lejuar. Me mënyrën e këtillë të udhëheqjes është mundësuar që makinat të drejtohen nga distanca më e madhe, të

zmadhohet prodhimi, të rritet kualiteti i prodhimit, të zvogëlohen shpenzimet dhe ngjashëm. Prodhimi i sotëm masiv dhe serik nuk mund të mendohet pa zbatimin e udhëheqjes automatike.

Udhëheqja automatike e tërë procesit në të gjitha llojet e termocentraleve, në fonderitë, industrinë e ilaçeve (barnave), në industrinë ushqimore, në industrinë automobilistike dhe elektronike dhe në degë të tjera të industrisë.

Udhëheqja e programuar automatike zbatohet te mjetet makinerike, te ato të ndërtimtarisë, tekstilit, xehetarisë dhe makinave të tjera.

Rregullimi automatik zbatohet te kazanët e avullit, avujt e ndryshëm, turbinat e gazit dhe ujit, tharësve, sistemeve për nxehje dhe klimatizim, proceseve kimike gjatë prodhimit të barnave, plehrave artificiale dhe të tjera.

Në kohën e sotme automatizimi është prezent në të gjitha sferat e jetës njerëzore dhe ka tendencë për zgjerimin dhe përsosjen e mëtutjeshme.

# 1. NOCIONET THEMELORE TË SISTEMEVE

## 1. 1 NOCIONI PËR SISTEMET

Nxënësit në këtë shkollë mësojnë sipas dëshirës së tyre të inspiruar nga nevojat e vendit tonë. Mu për këtë detyra themelore e shkollës është që në periudhën prej katër viteve nxënësve t'ju përcjellë njoħuri tē caktuara dhe t'i aftësoj pas mbarimit tē shkollës së mesme, dhe njoħuritë e fituara tē mund t'i zbatojnë në zgħidjen e problemeve profesionale me tē cilat do tē ballafaqohen gjatë punës së tyre jetësore. Nxënësit që do ta vazhdojnë shkollimin e mëtutjeshem edhe në fakultet njoħuritë e fituara duhet t'i shfrytëzojnë pér përsosjen e tyre tē mëtutjeshme. Që ta realizoj shkolla këtë detyrë është e nevojshme nē tē, tē punojnë mësimdhënës përkatës, personel teknikë dhe ndihmës tē tjerë, tē ketë lokale dhe pajisje përkatëse. Shkolla e tillë është tērësi e përbërë prej njësive tē veċanta, kurse ato njësi janë tē lidhura nē mënyrë funksionale nē tērësi me një qëllim themelor – zbatimin e detyrave tē parashtruara. Tērësia e këtillë e përbërë prej më shumë njësive formon sistem.

Në hidrocentrale kryhet shndërrimi i energjisë së ujit nē energji elektriqe. Që tē realizohet ky proces është e nevojshme tē ekzistoj instalimi hidroelektrik i cili nē rastin e përgjithshem përbëhet prej: akumulacionit, kanalit përcjellës, nivilit tē ujit, gypave tē ujit, hidroagregatit, përçuesit elektrik dhe transformatorëve pér transmetimin e energjisë elektriqe. Tē gjitha këto pjesë (njësi) së bashku me personelin e punësuar janë tē lidhur nē mënyrë funksionale nē tērësi – stabiliment hidroenergjetik i cili paraqet sistem.

Në termocentrale, energjia termike e lëndëve djegëse shndërrohet nē energji e elektriqe. Që tē mund kjo tē realizohet janë tē nevojshem: kazani i avullit, nxehħes i avullit, turbina e avullit, kondensatori, pompa, elektrogeneratori dhe tē tjetra. Tē gjitha këto pjesë ndërmjet tyre janë tē lidhura me qëllimin e vetem – fitimin e energjisë elektriqe. Tē gjitha pjesët së bashku me personelin e punësuar formojnë sistem.

***Sistemi është shuma e njësive (pjesëve, pajisjeve, organeve, nën sistemeve) tē lidhura nē mënyrë funksionale nē një tērësi pér shkak tē realizimit tē një qëllimi tē caktuar, me shfrytëzimin dhe këmbimin e energjisë, materies ose informacionit.***

Sistemet nē mes veti dallohen, por tē gjithë kanë karakteristika tē përbashkëta. Me qëllim që tē përmendën ato, sistemi shpesh shqyrtohet si një tērësi pa u treguar struktura e sistemit. Struktura dhe karakteristikat e sistemit shprehen nēpërmjet reaksioneve tē tij nga madhësitë e jashtme tē cilat veprojnë mbi tē. Gjatë shqyrtimit tē këtillë tē sistemeve përdoret tregimi simbolik me drejtkëndësh, kurse sistemi shënohet me "S". Tē gjitha ndikimet e qenësishme tregohen me shigjeta ndaj drejtkëndëshit, kurse tē gjitha reaksionet e tij

tregohen me shigjeta nga drejtkëndëshi. Shigjeta e tregon drejtimin e veprimit të madhësisë. Tregimi i këtillë simbolik quhet diagram i sistemit.



Figura 1.1 Tregimi simbolik i sistemit

Diagrami i sistemit i cili i tregon të gjitha njësitë e sistemit dhe veprimet ndërmjet tyre quhet diagram strukturor i sistemit.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Çka është sistemi dhe si paraqitet ai në mënyrë simbolike?
2. Thuaj një shembull për sistemin dhe shpjego se cilët janë njësitë e tij, cila është detyra e tij dhe çfarë këmbimi kryhet në të?

## 1.2 MADHËSITË HYRËSE DHE DALËSE

Në sistemin e një rasti të përgjithshëm veprojnë q madhësi të ndryshme, por vetëm n prej tyre ndikojnë mbi punën (sjelljen dinamike) të sistemit. Ato madhësi quhen madhësi hyrëse. Shënohen me  $x_{vl}$ , kurse veprimi i tyre në sistem shënohet me shigjeta kah drejtkëndëshi.

Si rezultat i madhësive hyrëse në sistem lajmërohen reaksione të sistemit. Nga disa prej tyre jemi të interesuar, kurse për disa jo. Ato reaksione për të cilat jemi të interesuar quhen madhësi dalëse të sistemit. Shënohen me  $x_i$ , kurse në diagram në mënyrë skematike janë treguar me shigjeta prej drejtkëndëshit.

*Madhësi hyrëse të sistemit nuk janë ato madhësi të cilët në kuptimin fizik hyjnë në sistem, por madhësitë që kanë ndikim të qenësishëm mbi sjelljen dinamike të sistemit, kurse janë krijuar jashtë tij.*

*Madhësi dalëse të sistemit nuk janë ato madhësi të cilët në kuptimin fizik dalin nga sistemi, por atë madhësi të cilat janë rezultat i sjelljes dinamike të sistemit (punës, procesit, lëvizjes) kurse për vlerën dhe ndryshimin e së cilës ne jemi të interesuar.*

Shembulli 1. Niveli i ujit në kazan varet prej rrjedhjes së ujit  $q_1$ . Ndryshimi i cilësdo nga këto madhësi e ndryshon nivelin e ujit në kazanin  $h$ , domethënë ka ndikim të rëndësishëm mbi sjelljen dinamike të sistemit. Për atë  $q_1$  dhe  $q_2$  janë madhësi hyrëse të sistemit, edhe pse  $q_2$  në kuptimin fizik del prej sistemit. Niveli i ujit  $h$  është madhësi dalëse në sistem sepse jemi të interesuar të mbetët konstant, edhe pse në kuptimin fizik nuk del prej sistemit.




Figura 1.2. Tregimi skematik dhe simbolik i kazanit i vështruar si sistem

Shembulli 2. Është e nevojshme të mbahet temperatura dhe presioni konstant i ajrit në hapësirë. Ndikimet e jashtme (dielli, ajri dhe shiu) ndikojnë mbi temperaturën dhe presionin e ajrit në hapësirë dhe ato i ndryshojnë, për atë ato janë madhësi hyrëse të sistemit. Temperatura dhe presioni i ajrit janë madhësi dalëse të sistemit, sepse ne jemi të interesuar të mbisin konstante, edhe pse në kuptimin fizik nuk dalin prej sistemit.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat janë madhësi hyrëse, ndërsa cilat janë dalëse të sistemit?
2. Shëno një shembull për sistemin dhe identifiko madhësitë e tij hyrëse dhje dalëse?

### 1.3. OBJEKTI DHE ÇRREGULLIMET

Sjellja e sistemit (punës) varet prej kërkesave të cilat shtrohen para tij.

Shembulli i 1. Prej sistemit të ngrohjes kërcohët të mbajë temperaturë të caktuar në hapësirë.

Shembulli 2. Nga pajisja klimatike kërcohët të mbajë temperaturë të caktuar, presion dhe lagështi në hapësirë.

Shembulli i 3. Nga kazani i avullit kërcohët të prodhoj avull me presion dhe rrjedhje të caktuar.

Shembulli i 4. Nga pompa kërcohët të jep lëng me presion dhe rrjedhë të caktuar.

Shembulli i 5. Nga termocentrali kërcohët të prodhoj energji elektrike me karakteristika të përcaktuara.

Shembulli i 6. Prej makinave ose veglave kërcohët të realizojnë regjim të përcaktuara të punës: numrin e rrotullimeve, thellimin e prerjes dhe të ngjashme.

***Sistemet të cilat duhet të realizojnë detyrën e dhënë të përcaktuar quhen objekte.***

Objektet posedojnë madhësi të përcaktuara hyrëse në bazën e së cilës e kryejnë punën e tyre, kurse si rezultat i punës të sistemit fitohen madhësi dalëse të sistemit. Objektet tregohen me drejtkëndësh, kurse shënohen me "O". Madhësitë hyrëse të objekteve tregohen me shigjeta ndaj drejtkëndëshit, kurse madhësitë dalëse tregohen me shigjeta nga drejtkëndëshi.




Figura 1.3. Tregimi simbolik i objekteve

Objektet teknike janë projektuar që të punojnë në disa kushte nominale për punë. Megjithatë kushtet e vërteta për punë të objekteve shpesh herë dallohen prej kushteve nominale. Për këtë shkak sjellja reale e objektit dallohet nga sjellja e kërkuar. Kjo krijohet si rezultat i veprimit të prishjeve të ndryshme të cilat veprojnë në objekt.

Shembulli i 1. Era shkakton shmangien e aeroplanit ose anijes prej kursit të përcaktuar.

Shembulli 2. Zmadhimi i presionit të ujit shkakton zmadhimin e nivelit të ujit në rezervuar.

Shembulli i 3. Zvogëlimi i fuqisë së nxehësisë së lëndës djegëse e zvogëlon fuqinë e motorit me djegie të brendshme.

Shembulli i 4. Mungesa e rrymës elektrike shkakton ndërprerjen e punës së pajisjeve të ndryshme elektrike.

Nga shembujt e përmendur mund të përfundojmë:

*Të gjitha madhësitë hyrëse të objektit të cilat shkaktojnë shmangje nga sjellja e tyre e vërtetë, nga sjellja e tyre e kërkuar, kurse ishin krijuar pa shfrytëzimin e informacioneve, për ato sjellje të kërkuara quhen çrregullime. Çrregullimet shënohen me z.*




Figura 1.4. Tregimi simbolik i objektit me çrregullime

Në objekt mund të veprojnë m shumë çrregullime të cilat shënohen me  $z_1$ ,  $z_2$ ,  $z_3 \dots z_n$ .


#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Çka është objekti dhe thekso ndonjë shembull për objektin?
2. Çka janë çrregullimet
3. dhe si ato ndikojnë mbi punën e objektit?
4. Thekso një shembull për objektin dhe shpjego ndikimin e çrregullimit mbi të?

#### 1.4. SISTEMET E UDHËHEQJES (MENAXHIMIT)

Asnjë objekt vetë nuk mund ta realizoj detyrën e dhënë pa veprimin e ndikimeve të jashtme. Kështu që asnjë termocentral nuk mund të prodroj vetë energji elektrike pa menaxhim. Boshti i turbinës nuk mund të kryen numrin e nevojshëm të rrotullimeve pa udhëheqje. Gjithashtu asnjë mjet transportues dhe asnjë aeroplan nuk mund të lëviz, pa mos pasur ndonjë drejtues.

Që të realizohet puna e objektit është e nevojshme mbi të, të veprojnë madhësi hyrëse. Ajo madhësi hyrëse e cila vepron mbi objektin me qëllim që të fitohet sjellja e kërkuar e objektit quhet **madhësia menaxhueze**. Shënohet me  $y$ , ndërsa nëse janë më shumë madhësi drejtuese ato janë komponentë të vektorit udhëheqës  $y$ . Detyra e madhësisë drejtuese është që ta siguroj sjelljen e kërkuar të objektit ose prapë shmangien e së vërtetës nga vlera e kërkuar të madhësisë dalëse të jetë në kufijtë e së lejuarës.



1.5. Madhësitë hyrëse, dalëse dhe çrrregullimet e objektit

Nëse mbi objektin vepron vektori i drejtimit atëherë ai udhëhiqet me sjelljen e tij dinamike. Objekti i tillë quhet **objekt i drejtuar(menaxhuar)**. Madhësitë hyrëse të objektit të drejtuar quhen **madhësi drejtuese(menaxhueze)**, kurse madhësitë e tij dalëse quhen **madhësitë e drejtuara(menaxhuara)**. Pjesa (njësia) e objektit mbi të cilin vepron madhësia drejtuese quhet **organ i drejtuar(menaxhuar)**.

Që të ekzistojnë madhësitë drejtuese është e nevojshme të ekzistoj sistem i cili do t'i prodhoj (realizoj) madhësitë drejtuese.


**Sistemi i cili me punën e tij krijon madhësi drejtuese (sistem, madhësitë dalëse të të cilit janë madhësitë drejtuese) quhet sistem udhëheqës. Shënohet me US.**



1.6. Madhësitë hyrëse dhe dalëse të sistemit udhëheqës

Meqenëse US është sistem i posaçëm ai i ka madhësitë e tij hyrëse të cilat jepin informacione për vlerat e këruara të madhësive të drejtuara. Sistemi udhëheqës gjatë formimit të madhësive drejtuese mund të përdorë edhe informacione për vlerën e vërtetë të madhësive dalëse dhe informacione për çrrregullime të cilat veprojnë mbi objekt.

*Sistemi i cili është i përbërë prej objektit dhe sistemit drejtues të cilët janë të lidhur me vektorin e drejtimit quhet sistem i udhëheqjes. Procesi i cili zhvillohet në sistemin e tillë quhet udhëheqje.*



1.7. Diagrami strukturor i sistemit të udhëheqjes

Në figurë është paraqitur sistemi i udhëheqjes kur udhëheqja formohet në bazë të informacioneve për sjelljen e kërkuar të objektit, sjelljen e vërtetë të objektit dhe nga çrregullimet.

Shembull 1. Është e nevojshme që automobili drejtë të lëvizë nëpër rrugë. Automobili është objekt i drejtuar, për shkak se atë e drejtojmë. Një madhësi drejtuese është lakimi i timonit, ndërsa madhësia e dytë drejtuese është fuqia tërheqëse e motorit. Madhësia e drejtuar është distanca nga tehu i rrugës i cili duhet të jetë konstant. Organi drejtues është timoni me ndihmën e të cilit e drejtojmë objektin. Ai e pranon madhësinë drejtuese të cilën e jep sistemi udhëheqës. Ai e ka informacionin për sjelljen e kërkuar të objektit (distanca nga tehu i rrugës të jetë konstante) dhe informacionin e çrregullimit (kthesa, tejkalimi dhe mjeti tjetër transportues dhe të ngashme).

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat janë madhësi drejtuese, kurse cilat janë të drejtuara?
2. Çka është objekti i drejtuar, kurse çka është organi udhëheqës?
3. Cili sistem quhet sistem udhëheqës?
4. Çka është sistemi i udhëheqjes?
5. Shëno shembullin për sistemin e udhëheqjes dhe identifiko pjesët dhe madhësitë e tij?

## 1.5. SISTEMI I UDHËHEQJES AUTOMATIKE DHE VLERAT E TIJ

Sistemet e udhëheqjes në varshmëri prej llojit të sistemit udhëheqës dhe llojit të udhëheqjes mund të jenë:

1. **Sisteme të udhëhequr me dorë** – sisteme në të cilët sistemi drejtues është njjeriu, kurse drejtimi është me dorë.

**2. Sisteme me udhëheqje gjysmë automatike** – sisteme në të cilët sistemi udhëheqës është i përbërë prej njeriut dhe pajisjes, kurse udhëheqja është gjysmë automatike.

**3. Sisteme me udhëheqje automatike** – sisteme në të cilët sistemi i udhëheqjes është pajisja ose më shumë pajisje, kurse udhëheqja është automatike.

**Udhëheqja automatike** e sistemeve ka numër të madh përparësish krahasuar me udhëheqjen me dorë dhe atë gjysmë automatike.

- Udhëheqja automatike siguron punë të saktë, të sigurtë, ekonomike të objektit pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të njeriut. Njeriu e mbikëqyrë punën e sistemit dhe e mbikëqyrë gjendjen e rregullt të sistemit për udhëheqje automatike. Puna e tij është intelektuale dhe ka mundësi ta përdorë për shpkje dhe ide të reja teknike.

- Udhëheqja automatike e liron njeriun nga puna në mjetet e pasigurta, nga puna në temperaturat e larta, puna në mjetet e ndotura dhe të ngjashme.

- Puna në disa objekte nuk mund të realizohet pa udhëheqjen automatike me to. Për shembull: prodhimi masiv serik, prodhimi i energjisë elektrike në centralet nukleare, prodhimi i ilaçeve ku kërkonhet preçizitet i madh, saktësi, siguri, ndryshime në kohë dhe të tjera.

- Shpejtësia e reagimit të njeriut është e kufizuar, kurse krahas saj njeriu i nënshtrohet lodhjes dhe dekoncentrimi. Për atë është e domosdoshme të kryhet udhëheqje automatike në procese të cilat zhvillohen me shpejtësi të madhe.

#### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Çfarë sisteme të udhëheqjes ekzistojnë?
2. Shpjego dallimet ndërmjet sistemeve me udhëheqje me dorë, gjysmë automatike dhe automatike?
3. Cilët janë përparësitë e udhëheqjes automatike?
4. Numëro shembuj të sistemeve, ku është e domosdoshme të ekzistoj sistem i udhëheqjes automatike?

#### **1.6. LLOJET E SISTEMEVE TË UDHËHEQJES AUTOMATIKE**


Ndarja e sistemeve në udhëheqje automatike mund të kryhet në më shumë mënyra. Më shpesh ndarja bëhet sipas informacionit që është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për udhëheqje të drejtë të objektit. Sipas këtij kriteri, sistemet për udhëheqje automatike mund të jenë:

1. **Sisteme të hapura të udhëheqjes automatike**
2. **Sisteme të myllura të udhëheqjes automatike**
3. **Sisteme të kombinuara të udhëheqjes automatike**

Te të gjitha sistemet e përmendura për udhëheqjen e objektit, përdoret informacioni për vlerën e kërkuar të madhësisë dalëse. Por, kjo nuk është çdoherë e mjaftueshme dhe në varshmëri prej asaj se cilat informacione të tjera janë të nevojshme ekzistojnë sistemet e theksuara të udhëheqjes automatike.

### 1. Sistemet e hapura të udhëheqjes automatike mund të jenë:


- a) pa kompensim të çrregullimeve
- b) me kompensim të çrregullimeve
- a)



1.8. SAU-të e hapura pa kompensim të çrregullimeve

*Sistemi i cili për udhëheqjen e rregullit të objektit përdor informacione vetëm për vlerën e kërkuar të madhësisë dalëse quhet sistem i hapur i udhëheqjes automatike pa kompensim të çrregullimeve.*


- b)



1.9. SAU-të e hapura me kompensim të çrregullimeve

*Sistemi i cili për udhëheqjen e rregullit të objektit përdor informacione vetëm për vlerën e kërkuar të madhësisë dalëse dhe për çrregullimet quhet sistem i hapur i udhëheqjes automatike me kompensim të çrregullimeve. Te ky sistem realizohet kompensimi direkt i çrregullimeve.*


### 2. Sistemet e mbyllura të udhëheqjes automatike



1.10. SAU-të e mbyllura

*Sistemi i cili për udhëheqjen e drejtë me objektin, shfrytëzon informacione për të kërkuar edhe vlerën vërtetë të madhësisë dalëse quhet sistem i mbyllur i udhëheqjes automatike. Këto sisteme kanë lidhje kthyese negative e cila është e domosdoshme që të mund sistemi drejtues ta verifikoj dallimin e vlerës së vërtetë dhe atë të kërkuar të madhësisë dalëse. Te këto sisteme ka kompensim indirekt të çrregullimeve i cili realizohet nëpërmjet informacionit për vlerën e vërtetë të madhësisë dalëse.*

### 3. Sistemet e kombinuara të udhëheqjes automatike



1.11. SAU-të e kombinuara

*Sistemi i cili për udhëheqjen e drejtë me objektin, shfrytëzon informacione për të kërkuar edhe vlerën e vërtetë të madhësisë dalëse dhe informacioneve për çrregullim quhet sistem i kombinuar. Te këto sisteme ka kompensim të drejtpërdrejtë dhe indirekt të çrregullimeve. Kompensimi i drejtpërdrejtë realizohet nëpërmjet informacionit të çrregullimeve, kurse indirektet nëpërmjet informacionit për vlerën e vërtetë të madhësisë dalëse.*

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Sipas cilave kritere është bërë ndarja e sistemeve të udhëheqjes automatike?
2. Çfarë sisteme të udhëheqjes automatike ekzistojnë?
3. Cili është dallimi ndërmjet sistemeve të hapura të udhëheqjes automatike me kompensim të çrregullimeve dhe sistemeve të hapura të udhëheqjes automatike pa kompensim të çrregullimeve?
4. Cilat janë sistemet e mbyllura të udhëheqjes automatike dhe cila është karakteristika e tyre themelore?
5. Cilat informacione përdoren për udhëheqje me objektet e sistemeve të kombinuara të udhëheqjes automatike?

## 1.7. SHEMBUJ TË SISTEMEVE TË UDHËHEQJES AUTOMATIKE

Në figura janë dhënë disa sisteme të udhëheqjes automatike.

Në shembullin e dhënë në figurën 1.12. është e nevojshme të mbahet presioni konstant në rezervuar. Pozita e levave 3 dhe pistoni 2 zhvendoset që të përgjigjet në presionin e kërkuar të rezervuarit 1. Nëpër gypin përcjellës në rezervuarin 1 vjen fluidi me rrjedhë  $q_1$  i cili pastaj nëpër gypin kthyes me rrjedhë  $q_2$  përcillet deri te konsumuesit. Nëse vjen deri te zmadhimi i presionit në rezervuarin 1, pistoni 2 do të lëviz lartë me çka do të lëvizin levat 3. Ndara 4 do të lëviz te poshtë, në rezervuar do të hynë sasi më e vogël e fluidit me çka presioni në rezervuar do të zgogëlohet dhe do të sillet (arrin) në vlerën e dëshiruar. Nëse presioni në rezervuar zgogëlohet, pistoni 2 do të lëviz te poshtë, do t'i lëviz levat 3 të cilat do ta lëvizin pjesën ndarëse 4 lartë. Në rezervuar do të hyjë sasi më e madhe e fluidit me çka presioni në rezervuar do të arrin vlerën e kërkuar.

Në shembullin e dhënë në figurën 1.13. është e nevojshme të ruhet temperatura konstante e ajrit në hapësirë. Në rrotullimin 2 dhe spiralen 3 akomodohet pozita e membranës 4 dhe hapja e valvolit 6 i cili i përgjigjet temperaturës së dëshiruar të ajrit në hapësirë. Temperatura e mjedisit matet me element matës pneumatik 1. Me ndryshimin e temperaturës së jashtme ndryshon temperatura e ajrit në hapësirën. Nëse temperatura e jashtme rritet, gazi në elementin matës zgjerohet dhe pastaj rritet presioni mbi membranën 4 nga motori pneumatik 5. Membrana lëviz lartë dhe leva që është e lidhur për të, e myllë valvolin 6. Me të në radiatorin 7 vjen sasi më e vogël e ujit të nxehjtë dhe temperatura e ajrit në hapësirë zgogëlohet dhe sillet në vlerën e dëshiruar.

Në shembullin e dhënë në figurën 1.14. është e nevojshme të ruhet temperatura konstante e ujit në rezervuar. Nga gypi i sipërm vjen uji me temperaturë  $t_1$  dhe rrjedhje  $q_1$ . Nga gypi i poshtëm vjen ujë me temperaturë  $t_2$  dhe rrjedhje  $q_2$ , me ç'rast  $t_1 < t_2$ . Elementi matës për rrjedhjen 1 informacionin përrnjedhjen e matur e dërgon në transmetuesin 2 i cili e përfalcon informacionin dhe e dërgon te mbledhësi 3. Dhënësi 4 dërgon informacion në mbledhësin 3 përvlerën e kërkuar të temperaturës së ujit në rezervuarin 8. Në bazë të këtyre dy informacioneve mbledhësi formon informacion të cilin e dërgon në organin transmetues 5, kurse pastaj në motorin 6. Motori pneumatik 6 në bazë të informacionit të marrë e hap ose e myll valvolin rregullues 7. Ndërsa nëse vjen deri te zmadhimi i temperaturës së ujit në rezervuar, motori 6 e myllë valvolin 7, në rezervuar vjen sasi më e vogël e ujit të ngrontë me çka zgogëlohet temperatura e ujit në rezervuar. Nëse temperatura e ujit në rezervuar zgogëlohet, motori 6 e hap valvolin 7, në rezervuar vjen sasi më e madhe e ujit të ngrontë me çka temperatura e ujit në rezervuar zmadhohet.

Në shembullin e dhënë në figurën 1.15. është e nevojshme të ruhet në mënyrë konstante niveli i lëngut në rezervuar. Nga gypi 2 sillet lëng në

rezervuarin 1 i cili pastaj dërgohet nëpër gypin 3 nga konsumuesit. Nëse vjen deri te zmadhimi i nivelit të lëngut në rezervuar, pluskuesi 4 ndalet lartë dhe i lëviz levat 5. Ndarja 6 lëvizë te poshtë, në rezervuar vjen sasi më e vogël e lëngut, kurse me këtë nivel i rezervuarit sillet në vlerën e dëshiruar. Nëse niveli i lëngut në rezervuar zvogëlohet, pluskuesi 4 lëviz te poshtë, i ndalon levat 5 dhe e ndalon ndarjen 6 lartë. Me këtë në rezervuar hynë sasi më e madhe e lëngut, niveli zmadhohet dhe sillet në vlerën e kërkuar.

Shembujt e përmendur shqyrtoj si sisteme të udhëheqjes automatike. Përpiqu t'i identifikosh madhësitë vijuese dhe pjesët e sistemeve:

- madhësitë hyrëse të sistemit
- madhësitë dalëse të sistemit
- çrrregullimet
- objekti
- sistemi drejtues
- organi drejtues
- madhësia drejtuese
- madhësia e drejtuar
- lloji i sistemit për udhëheqje automatike




Figura 1.12.

1- rezervuar  
2 – pistoni

3- levat  
4- ndarja




Figura 1.13.

1. elementi matës për temperaturë	5. motori pneumatik
2. kthina	6. valvoli
3. spiralja	7. radiatori
4. membrana	




Figura 1.14.

- |                                |                      |
|--------------------------------|----------------------|
| 1. elementi matës për rrjedhje | 5. organi përcjellës |
| 2. transmetues                 | 6. motor             |
| 3. mbledhës                    | 7. valvol            |
| 4. ngulfatës                   | 8. rezervuar         |




Figura 1. 15.

- |                   |             |
|-------------------|-------------|
| 1. rezervuar      | 4. pluskues |
| 2. gyp përcjellës | 5. levat    |
| 3. gypi kthyes    | 6. ndarjet  |

## MBAJE MEND (REZYME)

*Sistemi* është shuma e njësive (pjesëve, pajisjeve, organeve, nënsistemeve) që në mënyrë funksionale janë të lidhura në një tërësi për shkak të realizimit të qëllimit të caktuar me përdorimin dhe këmbimin e energjisë, materies ose informacionit.

**Madhësitë karakteristike te sistemet janë:**

**Madhësitë hyrëse të sistemit** nuk janë ato madhësi të cilat në kuptimin fizik hyjnë në sistem, por madhësitë të cilat kanë ndikim të genësishëm mbi sjelljen dinamike të sistemit, kurse janë të formuara jashtë atij sistemi.

**Madhësitë dalëse të sistemit** nuk janë ato madhësi të cilat në kuptimin fizik nuk dalin prej sistemit, por ato madhësi të cilat janë rezultat i sjelljes dinamike të sistemit (punës, procesit, lëvizjes), kurse për vlerën dhe ndryshimin e tyre ne jemi të interesuar.

Të gjitha madhësitë hyrëse të objektit të cilat shkaktojnë shhangje të sjelljes së tij të vërtetë nga sjellja e tij e kërkuar, kurse janë formuar pa shfrytëzimin e informacioneve për atë sjellje të kërkuar quhen **çrregullime**.

Ajo madhësi hyrëse e cila vepron mbi objekt me qëllim që të realizohet sjellja e kërkuar e objektit quhet **madhësi drejtuese**.

Madhësia dalëse prej objektit e cila duhet të sillet deri te vlera e kërkuar quhet **madhësi e drejtuar**.

Sistemi i cili është i përbërë prej objektit dhe sistemit drejtues të cilët janë të lidhur me vektorin e udhëheqjes quhet **sistem i udhëheqjes**. Procesi që zhvillohet në sistemin e tillë quhet **udhëheqje**.

**Pjesët e sistemit të udhëheqjes janë:**

Sistemet të cilët duhet të realizojnë detyrën e dhënë dhe të përcaktuar quhen **objekte**.

Sistemi i cili me punën e tij realizon madhësi drejtuese (sistem-madhësitë dalëse të të cilit janë madhësi drejtuese) quhet **sistem udhëheqje**.

Sistemet e udhëheqjes mund të janë:

Sistemi i cili për udhëheqjen e drejtë me objektin shfrytëzon informacione vetëm për vlerën e kërkuar të madhësisë dalëse quhet **SAU e hapur pa kompensim të çrregullimeve**.

Sistemi i cili për udhëheqjen e drejtë me objektin shfrytëzon informacione vetëm për vlerën e kërkuar të madhësisë dalëse dhe të çrregullimeve quhet **SAU e hapur me kompensim të çrregullimeve**.

Sistemi i cili për udhëheqjen e drejtë me objektin shfrytëzon informacione vetëm për vlerën e kërkuar dhe vlerën e vërtetë të madhësisë dalëse quhet **sistem i mbyllur i udhëheqjes automatike**.


Sistemi i cili për udhëheqjen e drejtë me objektin shfrytëzon informacione vetëm për vlerën e kërkuar dhe vlerën e vërtetë të madhësisë dalëse dhe informacione për çrregullimet quhet **sistem i kombinuar i udhëheqjes automatike**.

## 2. LIDHJET THEMELORE TË SISTEMEVE


Pjesët prej të cilave është i përbërë sistemi, ato ndërmjet tyre janë të lidhura në mënyrë të caktuar me çka formohet lloji i caktuar i lidhjes. Në varshmëri prej mënyrës së lidhjes së pjesëve të sistemeve janë të mundshme llojet vijuese të lidhjeve:

- 1. Lidhja rendore**
- 2. Lidhja paralele**
- 3. Lidhja kthyese**

### 2.1 LIDHJA RENDORE E SISTEMEVE



2.1 Lidhja rendore e dhomëzave



2.2. Lidhja rendore e levave


Te sistemet e dhëna në figurën 2.1 dhomëzat  $S_1$  dhe  $S_2$  janë të lidhura ashtu që madhësia dalëse nga nënsistemi  $S_1$ , është madhësi hyrëse në nënsistemin  $S_2$ . Madhësia hyrëse në nënsistemin  $S_1$  është madhësi hyrëse në krejt sistemin, kurse madhësia dalëse nga nënsistemi  $S_2$  është madhësi dalëse e krejt sistemit.

$$X_{vt} = X_{v/1}$$

$$X_{i2} = X_i$$

$$X_{i1} = X_{v/2}$$

E njëta vlen edhe për sistemin e paraqitur në figurën 2.2. Çdo njëri prej levave paraqet nënsistem. Ndalimi i levës së parë shkakton ndalimin e levës së dytë. Edhe për to vleinë të njëjtat relacione, që vlenin për sistemin e dhënë në figurën e parë. Diagrami strukturor i sistemit të këtillë është dhënë në figurën;



2.3 Diagrami strukturor i lidhjes rendore

**Nëse sistemi  $S$  përbëhet prej dy nënsistemeve të ndërlidhur  $S_1$  dhe  $S_2$ , ashtu që madhësia hyrëse në krejt sistemin është në të njëjtën kohë madhësi hyrëse në nënsistemin  $S_1$ , kurse madhësia dalëse e tij është madhësi hyrëse në nënsistemin  $S_2$ , madhësia dalëse e së cilit është, madhësia dalëse nga krejt sistemi, atëherë nënsistemet  $S_1$  dhe  $S_2$  janë të ndërlidhur në rend, kurse sistemi  $S$  është lidhje rendore e nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$ .**

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat illoje të lidhjeve janë të mundshme te sistemet?
2. Kur sistemi  $S$  është lidhje rendore e nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$ ?
3. Shprehe në mënyrë matematike lidhjen rendore të dy nënsistemeve?
4. Vizato diagramin strukturor të lidhjes rendore të dy nënsistemeve.
5. Trego shembull për nënsisteme të lidhura në lidhje rendore dhe shpjego lidhjet.

## 2.2. LIDHJA PARALELE E SISTEMEVE




Figura 2.4. Lidhja paralele të dhomëzat

Dhomëzat  $S_1$  dhe  $S_2$  paraqesin dy nënsisteme, kurse  $S_3$  është mbledhësi. Madhësitë hyrëse në nënsisteme janë të njëjta ndërmjet tyre dhe të njëjta në madhësinë hyrëse të krejt sistemit. Madhësia dalëse e krejt sistemit përcaktohet në mbledhësin  $S_3$  dhe varet prej madhësive dalëse të nënsistemave  $S_1$  dhe  $S_2$ . Madhësia dalëse e krejt sistemit mund të jetë shumë(mbledhje) ose dallim i madhësive dalëse të dy nënsistemave.

$$X_{vl} = X_{v/1} = X_{v/2}$$

$$X_i = X_{i1} \dots X_{i2}$$

*Nëse sistemi përbëhet prej dy nënsistemave  $S_1$  dhe  $S_2$ , madhësitë hyrëse të të cilave janë të barabarta me madhësinë hyrëse të krejt sistemit, kurse madhësia dalëse e krejt sistemit është shumë(mbledhje) ose dallim i madhësive dalëse të nënsistemave  $S_1$  dhe  $S_2$ , nënsistemet e tilla janë paralelisht të lidhura, kurse sistemi  $S$  është lidhja paralele e nënsistemave  $S_1$  dhe  $S_2$ .*

Diagrami strukturor i lidhjes së këtillë është dhënë në figurën;




Figura 2.5. Diagrami strukturor i lidhjes paralele

### PYETJE DHE DETYRA:

1. Kur sistemi  $S$  është lidhje paralele e nënsistemave  $S_1$  dhe  $S_2$ ?
2. Shprehe në mënyrë matematikore lidhjen paralele të dy nënsistemave?
3. Vizato diagramin strukturor të lidhjes paralele të dy nënsistemave?
4. Trego një shembull për nënsistemet e lidhura në lidhje paralele dhe shpjegoje lidhjen?

### 2.3 LIDHJA KTHYESE E SISTEMEVE




Figura 2.6. Sistemi me lidhje kthyese

Sistemi i dhënë në figurë është i përbërë prej dy dhomëzave  $S_1$  dhe  $S_2$  të cilët janë dy nënsisteme dhe mbledhës  $S_3$ . Nga ana e poshtme e membranës futet presioni hyrës në tërë sistemin  $x_{vi}$ , kurse nga ana e sipërme sillet presioni dalës nga nënsistemi  $S_2$ . Presioni dalës prej mbledhësit  $S_3$  është presion hyrës në nënsistemin  $S_1$ . Ai mund të jetë shumë (përmbledhje), ose dallim i madhësisë hyrëse të sistemit  $x_{vi}$  dhe madhësisë dalëse të nënsistemit të dytë  $x_{i2}$ . Presioni dalës prej nënsistemit  $S_1$  është presion dalës nga krejt sistemi  $x_i$  dhe presion hyrës në nënsistemin e dytë  $x_{vl2}$ .

$$X_{vi1} = x_{vi} \equiv x_{i2}$$

$$x_i = x_{i1} = x_{vl2}$$

**Nëse sistemi  $S$  përbëhet prej dy nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$  ku madhësia hyrëse në nënsistemin  $S_1$  është shumë, ose dallim i madhësisë hyrëse në sistem dhe madhësisë dalëse nga nënsistemi i dytë, kurse madhësia dalëse e tij është madhësi dalëse prej tërë sistemit dhe madhësisë hyrëse në nënsistemin e dytë  $S_2$  ndërsa sistemi  $S$  është sistem me lidhje kthyese.**

$$1) X_{vi1} = x_{vi} + x_{i2} \quad 2)$$

$$X_{vii} = x_{vi} - x_{i2}$$

Nëse vlen barazimi 1 sistemi është me lidhje kthyese pozitive, ndërsa nëse vlen barazimi 2 sistemi është me lidhje kthyese negative. Diagrami i sistemit të këtillë është dhënë në figurën e mëposhtme;




Figura 2.7. Diagrami strukturor i sistemit me lidhje kthyese

Dega a-b që fillon në hyrje të sistemit, kurse mbaron në daljen e tij quhet dega direkte ose kryesore. Dega b-c që fillon në dalje të sistemit, ndërsa mbaron në dalje të mbledhësit quhet dega kthyese.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Kur sistemi  $S$  është sistem me lidhje kthyese të nënsistemit  $S_1$  dhe  $S_2$ ?
2. Shprehe në mënyrë matematikore sistemin me lidhje kthyese të dy nënsistemeve?
3. Vizato diagramin strukturor të sistemit me lidhje kthyese të dy nënsistemeve?
4. Paraqite shembullin për nënsistemet e lidhura në sistemin me lidhje kthyese dhe shpjego lidhjen?

#### 2.4. FUNKSIONI TRANSMETUES I SISTEMEVE

Diagrami i sistemit e jep lidhjen ndërmjet elementeve të sistemit. Bllok diagrami i sistemit jep informacion për strukturën e sistemit dhe informacion për sjelljen dinamike të sistemit. Sjellja dinamike për çdo element të tij është dhënë me funksion transmetues.



Figura 2.8. Bllok diagrami i sistemit

*Funksioni transmetues i sistemit  $W(S)$  e tregon sjelljen dinamike të sistemit dhe përcaktohet si herës i madhësisë hyrëse dhe dalëse të sistemit.*

$$W(S) = \frac{X_i(S)}{X_{vl}(S)}$$

Funksioni transmetues i sistemit është i rëndësishëm për shkak se, mundëson analizën e sjelljes dinamike të sistemit. Barazimet me të cilat është argumentuar sjellja dinamike e sistemit formojnë model matematikor të sistemit.

Blok diagrami i sistemit është diagram strukturor i sistemit në të cilin të gjitha nënsistemet janë përshkruar me funksionet e tyre transmetuese. Ai mundëson përcaktimin e sistemeve ekuivalente në pikëpamje të sjelljes, edhe pse ato janë të ndryshme sipas strukturës. Ai e lehtëson studimin e sistemeve.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cili është dallimi ndërmjet diagramit të sistemit dhe blok diagramit të sistemit?
2. Çka është funksioni transmetues, si përcaktohet dhe për çka është ai i rëndësishëm?
3. Çka është modeli matematikor i sistemit?

#### 2.5. BLLOK DIAGRAMI EKUIVALENT DHE FUNKSIONI TRANSMETUES I LIDHJES RENDORE

Dy blok diagrame janë ekuivalente, vetëm edhe nëse barazimet të cilat fitohen prej tyre ndërmjet veti janë të barabarta.

Në figurë janë treguar lidhjet rendore të sistemeve funksionet transmetuese të të cilave janë  $W_1(S), W_2(S), W_3(S) \dots W_n(S)$ .




Figura 2.9. Blok diagrami në lidhjen rendore

Funksioni transmetues  $W(S)$  i lidhjes rendore nga figura është:

$$W(S) = W_1(S) \cdot W_2(S) \cdot W_3(S) \dots W_n(S)$$

Blllok diagrami ekuivalent për këtë lidhje është:





Figura 2.10. Blllok diagrami ekuivalent i lidhjes rendore

Argument:



Funksioni transmetues i krejt sistemit është:  $W(S) = \frac{X_i(S)}{X_{vl}(S)}$

$$X_{vl}(S) = x_{vl1}(S) \quad x_i(S) = x_{in}(S)$$

$$W(S) = \frac{x_{i1}(S)}{X_{vl1}(S)} \cdot \frac{x_{i2}(S)}{X_{vl2}(S)} \cdot \frac{x_{i3}(S)}{X_{vl3}(S)} \cdot \dots \cdot \frac{x_{in}(S)}{X_{vln}(S)}$$

$$W(S) = W_1(S) \cdot W_2(S) \cdot W_3(S) \dots W_n(S)$$

Funksioni transmetues i lidhjes rendore të  $n$  sistemeve është i barabartë me prodhimin e funksioneve të tyre transmetuese. Kjo rrjedh nëse vendi i sistemit në lidhjen rendore nuk ndikon në funksionin transmetues të krejt sistemit.

### PYETJE DHE DETYRA:

1. Kur dy blllok diagrame janë ekuivalente?
2. Si përcaktohet funksioni transmetues i lidhjes rendore?
3. Vizato blllok diagramin ekuivalent të lidhjes rendore?
4. Argumento barazimin për përcaktimin e funksionit transmetues të lidhjes rendore?
5. A ndikon vendi i sistemit të lidhjes rendore në funksionin transmetues të sistemit?

## 2.6. BLLOK DIAGRAMI EKUIVALENT DHE FUNKSIONI TRANSMETUES I LIDHJES PARALELE

Në figurën e mëposhtme është dhënë bllok diagrami i lidhjes paralele të  $n$  sistemeve.




Figura 2.11. Bllok diagrami i lidhjes paralele

Funksioni transmetues  $W(S)$  i lidhjes paralele të  $n$  sistemit është:

$$W(S) = W_1(S) + W_2(S) + W_3(S) + \dots + W_n(S)$$

Bllok diagrami ekuivalent i kësaj lidhje është dhënë në figurën vijuese.





Figura 2.12. Bllok diagrami ekuivalent i lidhjes paralele

Vërtetimi:



$$X_i(S) = X_{i1}(S) + X_{i2}(S) + X_{i3}(S) + \dots + X_{in}(S)$$

$$X_{vl}(S) = X_{vl1}(S) = X_{vl2}(S) = X_{vl3}(S) = \dots = X_{vln}(S)$$

$$W(S) = \frac{X_i(S)}{X_{vl}(S)} = \frac{X_{i1}(S) + X_{i2}(S) + X_{i3}(S) + \dots + X_{in}(S)}{X_{vl}(S)}$$

$$W(S) = \frac{X_i(S)}{X_{vl}(S)} = \frac{X_{i1}(S)}{X_{vl1}(S)} + \frac{X_{i2}(S)}{X_{vl2}(S)} + \frac{X_{i3}(S)}{X_{vl3}(S)} + \dots + \frac{X_{in}(S)}{X_{vln}(S)}$$

$$W(S) = W_1(S) + W_2(S) + W_3(S) + \dots + W_n(S)$$

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Si përcaktohet funksioni transmetues i lidhjes paralele?
2. Vizato bllok diagramin ekuivalent të lidhjes paralele?
3. Vërteto barazimin e përcaktimit të funksionit transmetues të lidhjes paralele?
4. A ndikon vendi i sistemit të lidhjes paralele në funksionin transmetues të sistemit?

#### 2.7. BLLOK DIAGRAMI EKUIVALENT DHE FUNKSIONI TRANSMETUES I SISTEMIT ME LIDHJE KTHYESE

Bllok diagrami dhe funksioni transmetues të cilët janë të lidhur me lidhje kthyese dhe me këtë rast sistemi  $S_2$  gjendet në degën kthyese i cili është treguar në figurën 2.13.




Figura 2.13. Bllok diagrami me lidhje kthyese

Funksioni transmetues i sistemit me lidhje paralele është:

$$W(S) = \frac{W_1(S)}{1 + W_1(S) \cdot W_2(S)}$$

Blok diagrami ekuivalent i sistemit me lidhje paralele është dhënë në figurën vijuese.





Figura 2.14. Blok diagrami ekuivalent i sistemit me lidhje kthyese

Në emëruesin e funksionit transmetues të lidhjes kthyese shenja (-) qëndron për lidhjen pozitive kthyese, kurse shenja (+) qëndron për lidhjen negative kthyese.

Vërtetimi:



$$X_{v11}(S) = x_{v1}(S) + (-) x_{i2}(S) \quad X_{v12}(S) = x_{i1}(S) = x_i(S)$$

$$X_{vi}(S) = X_{v11}(S) - (+) x_{i2}(S)$$

$$W(S) = \frac{X_i(S)}{X_{vi}(S)} = \frac{X_i(S)}{X_{v11}(S) - (+) x_{i2}(S)} = \frac{\frac{X_{i1}(S)}{X_{v11}(S)}}{1 - (+) \frac{X_{i2}(S)}{X_{v11}(S)}} = \frac{W_1(S)}{1 - (+) W_1(S) \cdot W_2(S)}$$

### PYETJE DHE DETYRA:

1. Si përcaktohet funksioni transmetues i sistemit me lidhje kthyese?
2. Vizato bllok diagramin ekuivalent të sistemit me lidhje kthyese?
3. Argumento barazimin e përcaktimit të funksionit transmetues të sistemeve me lidhje kthyese?
4. A ndikon vendi i sistemit në sistemin e lidhjes kthyese mbi funksionin transmetues të sistemit?

### MBANI MEND (REZYME):

Te sistemet, elementet e sistemit janë të lidhura ndërmjet veti që të mund të kryejnë funksionin e tyre. Në varshmëri prej mënyrës së lidhjes së nënsistemeve në sistem ekzistojnë tri lloje të lidhjeve:

Nëse sistemi  $S$  përbëhet prej dy nënsistemeve të lidhura  $S_1$  dhe  $S_2$ , kështu që madhësia hyrëse në krejt sistemin është në të njëjtën kohë edhe madhësi hyrëse në nënsistemin  $S_1$ , kurse madhësia e tij dalëse është madhësi hyrëse në nënsistemin  $S_2$ , madhësia dalëse e së cilës është madhësi dalëse nga tërë sistemi, atëherë nënsistemet  $S_1$  dhe  $S_2$  janë të lidhura në rend, kurse sistemi  $S$  **është lidhje rendore** e nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$ .

$$X_{vt}=X_{v/1}$$

$$X_{i2}=X_i$$

$$X_{i1}=X_{v/2}$$

Nëse sistemi përbëhet prej dy nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$  madhësitë dalëse të të cilëve janë të barabarta me madhësinë hyrëse në krejt sistemin, kurse madhësia dalëse nga tërë sistemi është shuma ose dallimi e madhësisë dalëse të nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$ , nënsistemet e këtilla janë paralelisht të lidhura, kurse sistemi  $S$  **është lidhje paralele** e nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$

$$X_{vi}=X_{v/1}=X_{v/2}$$

$$X_i=X_{i1} \dots X_{i2}$$

Nëse sistemi  $S$  përbëhet prej dy nënsistemeve  $S_1$  dhe  $S_2$  ku madhësia hyrëse e nënsistemit  $S_1$  është shumë ose dallim i madhësisë hyrëse në sistem dhe madhësi dalëse nga nënsistemi i dytë, kurse madhësia e tij dalëse është madhësi dalëse nga tërë sistemi dhe madhësi hyrëse në nënsistemin e dytë  $S_2$ , atëherë nënsistemi  $S_2$  gjendet në lidhjen kthyese të sistemit  $S$ , ndërsa sistemi  $S$  **është sistem me lidhje kthyese.**

$$X_{vi1}=X_{vi}=X_{i2}$$

$$X_i=X_{i1}=X_{vi2}$$

**Funksioni transmetues** i sistemit  $W(S)$  e tregon sjelljen dinamike të sistemit dhe është herësi i madhësisë hyrëse dhe dalëse të sistemit.

**Funksioni transmetues  $W(S)$  i lidhjes rendore** përcaktohet sipas barazimit:

$$W(S) = W_1(S) \cdot W_2(S) \cdot W_3(S) \dots \dots \dots W_n(S)$$

**Funksioni transmetues  $W(S)$ i lidhjes paralele** përcaktohet sipas barazimit:

$$W(S) = W_1(S) + W_2(S) + W_3(S) \dots \dots \dots + W_n(S)$$

**Funksioni transmetues i sistemit me lidhje kthyese** përcaktohet sipas barazimit:

$$W(S) = \frac{W_1(S)}{1 + W_1(S) \cdot W_2(S)}$$

### 3. STRUKTURA E SISTEMEVE TË RREGULLIMEVE

#### 3.1. SISTEMI I RREGULLIMEVE

Rregullimi është proces i cili zhvillohet në sistem të udhëheqjes dhe që siguron punë të kënaqshme në objekt kur mbi të veprojnë çrregullime. Me fjalë të tjera me **rregullim** nënkuftojmë ruajtjen e ndonjë madhësie të vlerës së saj të kërkuar.

Sistemi i rregullimit automatik në esencë është sistem i mbyllur i udhëheqjes automatike. Ndërmjet punës së sistemit të udhëheqjes automatike dhe sistemit të rregullimit nuk ka dallim të madh, për çka gjatë analizës së dy sistemeve shfrytëzohet teoria e njëjtë dhe të njëjtat nocione vetëm se me emra të tjera.




Figura 3.1. Diagrami strukturor i SAU-s

*Nëse për formimin e udhëheqjes së drejtë të objektit përdoret informacioni vetëm për shhangjen e sjelljes së tij të vërtetë nga sjellja e tij e kërkuar, atëherë sistemet e tillë të udhëheqjes janë quajtur sisteme të rregullimit (SAR).*

Në sistemet e rregullimit vlera e vërtetë e madhësisë dalëse vazhdimesh krahasohet me vlerën e tij të kërkuar. Kjo është e domosdoshme që të mund sistemi udhëheqës ta vërtetoj dallimin **E** ndërmjet vlerës së kërkuar dhe asaj të vërtetë të madhësisë dalëse të sistemit. Për atë qëllimi i sistemit të rregullimit ka lidhje negative kthyese të cilat mundësojnë që dallimi të jetë minimal. Domethënë detyra e lidhjes kthyese është ta përcjell informacionin për vlerën e vërtetë të madhësisë dalëse që të mund ajo të krahasohet me vlerën e kërkuar dhe mbi bazën e asaj, dallimi të formoj rregullimin e mëtutjeshëm në proces.

Dallimi ndërmjet madhësisë dalëse të kërkuar dhe të vërtetë të sistemit quhet **gabim**. Gabimi vërtetohet në pajisjen e posaçme – krahasuese. Krahasimi i diagramit është treguar me rreth të ndarë prej sistemit udhëheqës edhe pse në mënyrë konstruktive i takon atij.




Figura 3.2. Diagrami strukturor i SAR

Sistemet drejtuese te sistemet e rregullimit quhen **rregulator R**. Madhësitë udhëheqëse quhen **madhësi rregullative**, kurse madhësitë e drejtuara quhen **madhësi të rregulluara**. Organi drejtues quhet **organ rregullacioni (rregullimi)**, kurse procesi i udhëheqjes quhet **rregullacion**.

Nga diagrami shihet se ndërmjet rregulatorit dhe objektit ekziston mbledhës në të cilin mbi bazë të madhësisë rregulluese  $y$  dhe çrregullimeve z formohet madhësi rregullacioni  $y_0$  e cila ndikon mbi punën e objektit.

Shembull:




Figura 3.3. Rregullacioni në nivel të lëngut në rezervuar

Në rezervuarin 1 sillet lëng nga gypi 2, kurse dërgohet lëng prej gypit 3. Është e nevojshme të mbahet konstant niveli i lëngut në rezervuar. Nëse  $q_1 > q_2$  niveli i rezervuarit do të rritet dhe pluskuesi 4 do të lëviz lartë së bashku me levën vertikale. Skaj i majtë i levës 5 do të lëvizë teposhtë, do të lëviz ndarjen 6 me çka do të zvogëlohet rrjedha e lëngut në rezervuar.

Në shembullin e përmendur rregulator është ndarja 6, ndërsa objekt është rezervuari 1. Madhësia e rregulluar është niveli i lëngut, kurse madhësia e rregullimit është zhvendosja e ndarjes. Madhësia hyrëse e sistemit është nivel i dhënë i lëngut (shembull-rezervuari duhet të jetë plot). Elemente të lidhjes kthyese janë pluskuesi 4 dhe levat 5. Madhësia kthyese e sistemit është pozita e pluskuesit 4 i cili vazhdimisht krahasohet me madhësinë e dhënë (rezervuari i plotë) për t'u vërtetuar madhësia rregulative.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat sisteme të udhëheqjes quhen sisteme të rregullimit?
2. Çka është karakteristike për sistemet e rregullimit?
3. Vizato diagramin e sistemit të rregullimit dhe shpjego pjesët dhe madhësitë e tij?
4. Përmend një shembull për sistemin e rregullimit dhe identifiko pjesët dhe madhësitë e tij?

### 3.2. ORGANET E SISTEMEVE TË RREGULLIMIT

Detyra e rregulatorit është që në bazë të informacionit për gabimin e madhësisë së rregulluar të siguroj punë të kënaqshme të objektit, pa i marrë parasysh çrregullimet. Për realizimin e kësaj detyre rregulatori duhet të përmban kushte të caktuara të cilat quhen **organe**.




Figura 3.4. organe të sistemeve të rregullimit

Në figurë është paraqitur diagram i përgjithshëm strukturor i sistemit të rregullimit, i cili përbëhet prej rregulatorit dhe objektit. Organet të cilat duhet t'i përmbajë sistemi i rregullimit që të mund të kryej detyrën e vetë janë si vijojnë:

**Organe të rregulatorit (rregulluesit):**

1. **Dhënësi** – organ për vendosjen dhe mbajtjen mend të sjelljes së kërkuar të objektit.

2. **Organ i matës** – ka për detyrë të kryej matjen e vlerës së vërtetë të madhësisë së rregulluar dhe të dërgoj sinjal për të te mbledhësi.

3. **Krahasuesi** – ka për detyrë ta vërtetoj gabimin (shmangien e së vërtetës nga sjellja e kërkuar e objektit) dhe të dërgoj sinjal për të.

4,5,6,7. **Organe korrektuese përcjellëse** – shërbejnë që të mund rregulatori të siguroj sjellje përkatëse mbi objektin.

8. **Organ i ekzekutiv i rregulatorit** – ka për detyrë të siguroj intensitet të mjaftueshëm të veprimit d.m.th. fuqi veprimi që do të jetë e mjaftueshme përlëvizje të saktë dhe efikase të organit rregullues të objektit.

9. **Organ i rregullativ i objektit** – ka për qëllim që mbi bazën e sinjalit pranues, nga rregulatori të kryej ndryshime në madhësinë rregullative të sistemit.

10. **Pjesa punuese e objektit** – ka për detyrë të siguroj barazimin e madhësisë së rregulluar me vlerën e dhënë të tij.

Ndonjëherë disa nga organet e theksuara në mënyrë konstruktive janë bashkuar si një element, i cili kryen funksion të më shumë organeve.

**PYETJE DHE DETYRA:**

1. Cila është detyra e rregulatorit në sistemin e rregullimit?
2. Cilat organe i përmban rregulatori dhe cila është detyra e tyre?
3. Cilat organe i përmban objekti dhe cila është detyra e tyre?

### 3.3 RREGULATORËT

#### 3.3.1. RREGULATORËT – LLOJET DHE NDARJA

Ekzistojnë më shumë ndarje të rregulatorëve. Në varshmëri prej energjisë së nevojshme përlëvizjen e organeve ekzekutive ekzistojnë:

1. **Rregulatorë me veprim direkt**
2. **Rregulatorë me veprim indirekt**

Te rregulatorët me veprim direkt gjatë ndryshimit të madhësisë rregullative organi ekzekutiv lëviz me shfrytëzimin e energjisë që është në disponim në vetë objektin. Këto rregulatorë mund të shfrytëzohen vetëm kur sinjali matës është mjaft i madh përvienien në lëvizje të organit ekzekutiv.

Te rregulatorët me veprim indirekt për vënien në lëvizje të organeve ekzekutive shfrytëzohet energjia ndihmëse (pneumatike, elektrike, hidraulike) sepse sinjali matës nuk është mjaft i fuqishëm për t'i vënë në lëvizje organet ekzekutive. Sipas llojit të energjisë ndihmëse rregulatorët me veprim indirekt mund të jenë: pneumatikë, hidraulikë, elektrikë dhe të kombinuar.

**Në varshmëri prej karakteristikës së veprimit të rregulatorit,** dallohen llojet vijuese të rregulatorëve:

1. *Rregulatorët proporcionalë (P)*
2. *Rregulatorët integralo proporcionalë (PI)*
3. *Rregulatorët diferencialë porporcionalo-integralë (PID)*
4. *Rregulatorët integralë (I)*
5. *Rregulatorët diferencialo proporcionalë (PD)*

Tri llojet e para të rregulatorëve kanë zbatim të gjerë, kurse lloji i katërtë dhe i pestë më rrallë përdoren.

Me **karakteristika të veprimit të rregulatorit** nënkuptohet lloji i drejtimit të rregulatorit në varshmëri nga lidhja funksionale e gabimit, e cila është madhësi hyrëse në rregulator, dhe madhësia rregulatorore që është madhësi dalëse në rregulator me të cilën ai vepron mbi objekt.

#### **PYETJE DHE DETYRA:**


1. Cili është dallimi ndërmjet rregulatorit me veprim direkt dhe rregulatorit me veprim indirekt?
2. Çka nënkuptohet me karakteristikë të veprimit të rregulatorit?
3. Çfarë mund të jenë rregulatorët sipas karakteristikës së veprimit?

### **3.3.2. RREGULATORËT ME VEPRIM DIREKT DHE INDIREKT**

#### **RREGULATORËT ME VEPRIME DIREKTE**

Te rregulatorët me veprim direkt gjatë ndryshimit të madhësisë rregullative organi ekzekutiv fillon të lëviz me shfrytëzimin e energjisë që është në disponim të objektit. Ajo ka fuqi të dyfishtë për vënien në lëvizje të organit ekzekutiv që mundëson zbatimin e procesit të rregullimit.

Në figurën 3.5. është dhënë një shembull për rregulator me veprim direkt. Është e nevojshme që të kryhet rregullimi i presionit të gazit në rezervuarin 1. Për vënien në lëvizje të organit ekzekutiv përdoret energjia e gazit nga rezervuari.



*Figura 3.5. Rregulator me veprim direkt*

Me anë të vidës dhe spirales zhvendoset pozita e membranës 4 në varshmëri nga presioni i nevojshëm i gazit në rezervuar 1. Kur presioni i gazit në rezervuar do të bie (për shkak të konsumit të rritur të gazit) në rezervuar vjen gaz prej gypit 2 të organit ekzekutiv 3 i cili në këtë rast është motor pneumatik. Në këtë mënyrë presioni i gazit nga ana e poshtme e membranës 4 zvogëlohet. Membrana vihet në lëvizje te poshtë dhe e shtyp levën vertikale 5 dhe valvolin 6 te poshtë. Valvoli gjashtë hapet, në rezervuar hynë sasi më e madhe e gazit me çka presioni rritet dhe sillet në vlerën e kërkuar. Domethënë, në këtë shembull është realizuar rregullimi direkt, me rregulator direkt, ku energjia e gazit është shfrytëzuar për vënien në lëvizje të organit ekzekutiv.

Në shembullin e paraqitur me vidhën dhe spiralen jepet vlera e kërkuar e presionit në rezervuar, që do të thotë ato janë induktues në sistem. Membrana 4 është përcjellëse e cila e ka vërtetuar dallimin e vlerës së kërkuar dhe të vërtetë të presionit. Motori pneumatik 3 është organ ekzekutues i rregulatorit, i cili e formon madhësinë rregulluese që në këtë rast është lëvizja e levës 5. Valvoli 6 është organ rregullativ i objektit i cili në bazë të madhësisë rregulluese hapet ose mbyllt dhe lëshon sasi të caktuar të gazit në rezervuar. Rezervuari 1 është pjesa punuese e objektit ku vjen deri te barazimi i vlerës së kërkuar dhe të vërtetë të presionit të gazit.

## RREGULLATORË ME VEPRIM INDIREKT

Te rregullatorët me veprim indirekt për vënien në lëvizje të organit ekzekutiv shfrytëzohet energjia ndihmëse, për shkak se energjia e cila është në disponim në objekt nuk është e mjaftueshme për vënien në lëvizje të organit ekzekutiv.




Figura 3.6. Rregulator me veprim indirekt

Në figurën 3.6 është dhënë rregullatori me veprim indirekt. Është e nevojshme që të kryhet rregullim i presionit të gazit në rezervuarin 7. Me ndihmën e vidhës 1 dhe spirales 2 zhvendoset pozita e levës 3, kurse me këtë edhe presioni i nevojshëm i gazit në rezervuar. Nëpërmjet përcuesit pneumatik 4 sillet gaz i cili shërben për vënien në lëvizje të membranës nga organi ekzekutiv 5 dhe vënia në lëvizje e valvolit 6. Nëse presioni i gazit në rezervuarin 7 zvogëlohet për shkak të rritjes së konsumit, membrana dhe leva nga motori pneumatik 8 lëvizin te poshtë. Me këtë vihet në lëvizje edhe leva 3 te poshtë dhe e mbyllë përcuesin 4. Sasia më madhe e gazit hynë në organin ekzekutiv 5, membrana dhe leva vihen në lëvizje te poshtë dhe e hapin valvolin 6. Sasia më e madhe e gazit hynë në rezervuar, me çka presioni në rezervuar rritet dhe sillet në vlerën e kërkuar.

Në shembullin e vënies në lëvizje të organit ekzekutiv 5 përdoret energjia ndihmëse pneumatike.

Në shembullin e paraqitur me vidhën 1 dhe spiralen 2 përshtatet presioni i nevojshëm i gazit në rezervuar, që do të thotë ato janë induktues në sistem. Motori pneumatik 8 është organ matës i cili e matë vlerën pneumatike të presionit të gazit në rezervuar dhe jep sinjal për të me anë të zhvendosjes së levës vertikale. Leva horizontale 3 është krahasuese e cila e vërteton gabimin. Përcuesi pneumatik 4 është përfocues dhe shndërrues sepse lëvizjen e levës 3

e shndërron në presion që vjen në motorin pneumatik 5. Motori pneumatik 5 është organ ekzekutiv i rregulatorit i cili e formon madhësinë rregulluese, ndërsa ajo në fakt është vënie e lëvizjes së levës vertikale. Valvoli 6 është organ rregullativ i objektit i cili mbi bazën e madhësisë rregullative hapet ose mbyllt dhe lëshon sasi të caktuar të gazit në rezervuar. Rezervuari 7 është pjesa punuese e objektit në të cilin presioni i gazit sillet në vlerën e kërkuar.

### 3.3.3 LLOJET E RREGULATORËVE SIPAS KARAKTERISTIKËS SË VEPRIMIT TË RREGULATORIT

Sipas karakteristikave të veprimit të rregulatorit ekzistojnë më shumë lloje të rregulatorëve të cilët paraprakisht ishin përmendur. Meqenëse më shpesh përdoren P,PI dhe PID rregulatorët, në vazhdim do të shqyrtohen karakteristikat e tyre.




Fig. 3.7 P,PI,PID rregulatorët

**1. P – rregulator** Ky lloj i rregulatorëve vepron në mënyrë proporcionale me gabimet. Vënia në lëvizje e organit ekzekutiv është proporcionalisht me gabimet. Këto rregulatorë veprojnë shpejt, me fuqi të mjaftueshme, por nuk kanë lëngshmëri të madhe.

**2. Pi – rregulatori** Ky lloj i rregulatorit është kombinim i rregulatorëve p dhe rregulatorëve I. Në momentin fillestar vepron si rregulator P, kurse pas një kohe të caktuar vepron si rregulator I. Gjatë fitimit të sinjalit për gabim e zhvendos organin ekzekutiv (vepron pjesa P nga rregulatori), kurse pastaj me fuqinë lëvizëse më të ngadalësuar të organit ekzekutiv me saktësi të madhe (vepron pjesa e I nga rregulatori) e përmirëson gabimin. Me anë të kombinimit e rregulatorit P dhe rregulatorit I fitohet rregulator i cili vepron shpejt dhe me saktësi të madhe.

**3. RID – rregulatori** Këto rregulatorë janë kombinim i rregulatorëve P, I dhe D. I bashkojnë vetitë e mira të të tri llojeve themelore të rregulatorëve. Në momentin fillestar vepron si rregulator D. Gjatë pranimit të sinjalit për ndonjë gabim, në mënyrë impulsive dhe me shpejtësi të madhe vepron në organin rregullativ. Me këtë pamundësitet që të vihet deri te një shmangje e madhe e madhësisë rregulluese nga vlera e saj e kërkuar. Pastaj vepron pjesa P nga rregulatori. Ajo mundëson përforcim mjaft të fuqishëm dhe konstant që i jep stabilitet sistemit. Në fund vepron pjesa I e rregulatorit. Ajo mundëson saktësi të madhe dhe plotësisht e mënjanon gabimin.


#### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Cili është dallimi ndërmjet rregulatorit me veprim direkt dhe rregulatorit me veprim indirekt?
2. Shpjego parimin e punës së rregulatorit me veprim direkt dhe rregulatorit me veprim indirekt?
3. Shpjego organet e sistemit të rregullimit në shembujt për rregulatorë me veprim direkt dhe indirekt?
4. Sipas karakteristikave të veprimit të rregulatorëve ekzistojnë më shumë lloje të rregulatorëve. Cilat prej tyre më shumë përdoren?
5. Cilat karakteristika i kanë P, PI dhe RID rregulatorët dhe si veprojnë ato?

### **3.4. DHËNËSIT**

Elementet të cilët shërbejnë për mbajtje mend të vlerës së dëshiruar të madhësisë së rregulluar quhen dhënësit. Çfarë elementi do të zbatohet në rregulator varet nga ajo se madhësia e kërkuar është konstante ose ndryshon gjatë kohës.

Nëse madhësia e kërkuar është konstante dhënësit kanë konstruksion të rëndomtë. Në këtë rast mund të shfrytëzohen elementet vijuese.



Në shembullin e dhënë në figurën nën a. pozita e mbështetësit e përcakton vlerën e kërkuar të madhësisë rregullative. Te elementet e dhëna në figurën nën b, c dhe ç. shtrëngimi i spirales e përcakton vlerën e kërkuar të madhësisë së rregulluar. Te elementët e figurës nën d. madhësia dalëse është përcaktuar me presionin të gazit në barkun elastik, kurse te elementi i dhënë në figurën nën g. presioni i gazit i cili hynë në gyp është proporcional me dalësin.




Fig. 3.8. Dhënësit

Ligji sipas të cilit duhet të ndryshoj madhësia dalëse duhet të jetë i paraqitur në formën e bregut, sikurse te elementet e dhëna në figurën nën 3. të cilët lëvizin.

## PYETJE DHE DETYRA:

1. Cila është detyra e dhënësve në sistemin e rregullimeve?
2. Prej çka varet lloji i dhënësit që do të zbatohet në rregulator?
3. Shpjego parimin e punës së dhënësve, të dhënë në figurën 3.8.

## 3.5. ELEMENTET MATËSE

### 3.5.1. ELEMENTET MATËSE PËR PRESION

Elementet matëse për presion kanë për detyrë ta vërtetojnë vlerën e vërtetë të presionit dhe të japid sinjal për të, që të dërgojnë deri te krahasuesi.




Fig. 3.9. Elementet matëse për presion

Më shpesh elementet matëse të presionit janë edhe shndërrues. Në figurë janë dhënë disa prej elementeve themelore për matjen e presionit. Në figurën nën a. është dhënë elementi membranor ku zhvendosja e membranës është proporcionale me presionin e gazit i cili hynë në element. Te elementi në figurën nën b. vënja në lëvizje e barkut elastik është proporcional me presionin e gazit i cili hynë në barkun elastik. Rrotullimi i cili ndodh për shkak të zgjatjes së gypit të Burdonit – figura nën v. është proporcional me presionin e gazit i cili hynë në të, ndërsa e njëjtë edhe për peshojën unazore të dhënë në figurën nën d. Rrotullimi i tij është pasojë e ndryshimit të pozitës së synimit të tij, që ndodh për shkak të ndryshimeve të renditjes së masave gjatë ndryshimit të presionit të gazit. Lëvizja e ziles tek elementi nën figurën nën g. dhe lëvizja e pistonit te figura nën gj. ndodh gjatë ndryshimit të presionit të gazit i cili hynë në elemente.

### 3.5.2. ELEMENTET MATËSE TË RRJEDHËS

Elementet matëse për rrjedhën kanë për detyrë ta vërtetojnë vlerën e vërtetë të rrjedhës dhe sinjalin e vlerës ta dërgojnë deri te mbledhësi.




Fig. 3.10 Elementet matëse të rrjedhës

Në këto figura janë dhënë elementet matëse për rrjedhën, të cilët punojnë mbi parime të ndryshme. Elementet e dhëna në figurën nën a. dhe nën b. e masin rrjedhën me matjen e rënies së presionit i cili ndodh për shkak të ndryshimit të prerjes së gypit nëpër të cilin kalon fluidi. Te elementi e figurës nën a. matet presioni i fluidit në hyrje të gypit dhe në vendin e ngushticës më të madhe. Te elementi në figurën nën b. shfrytëzohet okulari B për zvogëlimin e prerjes së gypit. Matet presioni para dhe pas okularit. Në të dy rastet rrjedha është proporcionale me rënien e presionit. Kjo sjell deri te lëvizja e membranës dhe levës e cila është e kapur për të. Ajo lëvizje është proporcionale me rrjedhën. Te elementi në figurën nën v. lëvizja e levës është proporcionale me rrjedhën e fluidit i cili kalon nëpër element. Në figurën nën gj. është dhënë elementi matës i përshtapjimit të rrjedhës. Numri i rrotullimeve është proporcional me rrjedhën. Te elementi në figurën nën d. lëvizja e pluskuesit dhe levës është proporcionale me rrjedhën.

### 3.5.3 ELEMENTET MATËSE PËR NIVELIN E LËNGSHMËRISË

Elementet matëse për nivelin e lëngshmërisë kanë për detyrë ta vërtetojnë vlerën e vërtetë të nivelit të lëngshmërisë dhe të dërgojnë sinjal për të deri te mbledhësi.




Fig. 3.11 Elementet matëse për nivelin e lëngshmërisë

Elementi matës në figurën nën a. direkt e përcakton nivelin e lëngshmërisë. Lëvizja e pluskuesit dhe levës është proporcionale me ndryshimin e nivelit të lëngshmërisë. Elementet matëse të nivelit të lëngshmërisë, të dhëna në figurat nën b, g dhe d nivelin e masin nëpërmjet matjes së presionit hidrostatik të lëngshmërisë. Ajo sjell deri te një lëvizje të membranës dhe levës e cila është e lidhur me të. Kjo do të thotë se lëvizja e membranës dhe levës është proporcionale me ndryshimin e nivelit të lëngshmërisë. Te elementet e figurës nën v. niveli i lëngshmërisë matet nëpërmjet teknikës së lëngshmërisë në gypin 1 që bën shtypje në spirale. Tërheqja e spirales është proporcionale me nivelin e lëngshmërisë.

### 3.5.4. ELEMENTET MATËSE TË TEMPERATURËS

Elementet matëse të temperaturës kanë për detyrë të masin temperaturën e vërtetë dhe informacionin për të, ta dërgojnë deri te krahasuesi.




Fig. 3.12. Elementet matëse të temperaturës


Në figurën nën a. është dhënë elementi matës hidropneumatik për temperaturën, kurse në figurën nën b. është dhënë elementi matës pneumatik për temperaturën. Te të dy elementet matëse me rritjen e temperaturës vjen deri te zgjerimi i fluidit (lëngu ose gazi). Me këtë rritet presioni mbi membranën, e cila sjell deri në lëvizjen e membranës dhe të levës. Lëvizja e tyre është proporcionale me ndryshimin e temperaturës. Elementi matës bimetal i dhënë në figurën nën v. përbëhet prej dy metaleve (shembull krom-bakër ose krom-alumin) me koeficient të ndryshëm të përhapjes. Gjatë ndryshimit të temperaturës vjen deri te lëvizja e skajit të lirë të bimetalit. Në figurën nën g. është dhënë elementi matës i diletacionit për temperaturën. Gjatë rritjes së temperaturës leva vertikale zgjatet dhe e lëviz levën horizontale. Te elementi në figurën nën d. formohet tension i caktuar i cili është përkatës me temperaturën. Të gjitha këto elemente matëse janë në të njëjtën kohë edhe shndërrues.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cila është detyra e elementeve matëse në sistemin e rregullimeve?
2. Shpjego parimin e punës së elementeve matëse për presion, rrjedhje, nivelin e lëngshmërisë dhe të temperaturës?

### 3.6. PËRFORCUESIT

Përforcuesit janë elemente të cilët kanë për detyrë që sinjalin hyrës ta zmadhojnë për disa herë. Sinjalet hyrëse dhe dalëse janë të natyrës së njëjtë, për dallim nga ajo që sinjali dalës është disa herë më i fuqishëm sesa ai hyrës.






Fig. 3.13 Përforcuesit

Përforcuesi i dhënë në figurën nën a. mund të realizohet me piston, membranë ose bark elastik. Presioni hyrës vepron mbi pistonin, membranën ose barkun. Ato i shtyp dhe i lëviz leva vertikale me çka mbyllët hapja e djathtë e gypit. Nëpërmjet hapjes së majtë të gypit del sasi më e madhe e ajrit. Në këtë mënyrë sinjali dalës është i përforcuar. Te elementi i figurës b. sinjali hyrës e ruan levën me çka e përcakton fortësinë e sinjalit dalës. Te elementi në figurën nën g. sinjali hyrës e zhvendos levën e cila e zhvendos gypin vertikal. Me këtë mbi pistonin vepron sasi e madhe e ajrit, lëvizja e tij është më e madhe, që do të thotë sinjali dalës përforcohet. Te elementi i figurës nën v. e njëjtë ndodh vetëm se sinjali hyrës e lëviz levën horizontale dhe vertikale. Dhe këtu sinjali dalës është lëvizës i pistonit dhe levës. Te elementi i figurës nën d. sinjali hyrës i shtyp pistonat te poshtë me çka lirohet hapja e poshtme. Mbi pistonin vepron sasi më e madhe e ajrit që sjell deri në përforcimin e sinjalit dalës.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cila është detyra e përforcuesve në sistemet e rregullimeve?
2. Shpjego parimin e punës së përforcuesve të dhënë në figurën 3.13.

### 3.7 SHNDËRRUESIT

Shndërruesit kanë për detyrë që madhësinë hyrëse prej një natyre ta shndërrojnë në madhësi hyrëse të natyrës tjetër. Të gjitha elementet matëse mund të përdoren si shndërrues.




Fig. 3.14. Shndërruesit

Në figurën nën a. është dhënë shndërrues tek i cili madhësia hyrëse është lëvizje e levës vertikale, kurse madhësia dalëse është presion i gazit. Domethënë, te ky shndërrues lëvizja shndërrohet në presion. Te shndërruesi në figurën nën b. madhësia hyrëse është lëvizje drejtvizore e pistonave 1, kurse madhësia dalëse është lëvizje rrëthore e pistonit të rrotacionit 3. Domethënë, lëvizja drejtvizore shndërrohet në lëvizje rrëthore. Lëvizjet drejtvizore të pistonave të cilat janë madhësi hyrëse të shndërruesit e figurës nën v. Kështu që shndërruesi e shndërron në rrjedhë që është madhësi dalëse e tij. Në figurën nën g. është dhënë shndërruesi i cili lëvizjen e shndërron në tension. Potenciometri 2 duke lëvizur në mënyrë drejtvizore nëpër rezistuesin 1 formon tension elektrik.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cila është detyra e shndërruesve në sistemet e rregullimeve?
2. Shpjego parimin e punës së shndërruesve të dhënë në figurën 3.14.?

### 3.8 KRAHASUESIT

Për realizimin e procesit të rregullimit është i domosdoshëm të vërtetohet gabimi d.m.th. dallimin ndërmjet vlerës së kërkuar dhe të vërtetë të madhësisë së rregulluar. Për këtë shërbejnë krahasuesit dhe prandaj ato kanë rëndësi të madhe funksionale.

Madhësitë hyrëse në krahasuesin e figurës nën a. janë lëvizjet e levave vertikale në anën e sipërme të krahasuesit. Ato lëvizin në drejtime të ndryshme. Drejtimi i lëvizjes së madhësisë hyrëse më të madhe e përcakton drejtimin e lëvizjes së levës vertikale nga ana e poshtme e krahasuesit, që paraqet madhësi dalëse të krahasuesit. Te krahasuesi në figurën nën b. mbi membranën nga anë të ndryshme veprojnë dy madhësi hyrëse të ndryshme. Dallimi i fortësisë së tyre e lëviz membranën lartë ose poshtë. Së bashku me të lëviz edhe leva e cila e lëviz edhe membranën e poshtme. Lëvizja e saj e përcakton madhësinë dalëse të krahasuesit. Te krahasuesi i cili është në figurën nën v. madhësitë hyrëse veprojnë në skajet e levave. Me krahasimin e fortësisë së tyre përcaktohet madhësia dalëse e krahasuesit. Dallimi i fortësisë përcakton a do të rrotullohet skaji i djathtë ose i majtë i levës që paraqet madhësi dalëse nga krahasuesi. Te krahasuesi në figurën nën g. dallimi i madhësive hyrëse të cilat veprojnë nga anë të ndryshme të pistonit e përcakton drejtimin e lëvizjes së pistonit që paraqet madhësi dalëse të krahasuesit. Krahasuesi i dhënë në figurën nën d. përmban dy valvola dhe bark elastik. Të genurit hapur të valvolave e përcaktojnë madhësinë hyrëse të krahasuesit. Dallimi i madhësive hyrëse (dallimi i sasisë së fluidit i cili kalon nëpër valvola) e

përcakton madhësinë dalëse të krahasuesit i cili në këtë rast është lëvizje e barkut elastik dhe levës.




Fig. 3.15. Krahasuesit

Te krahasuesi, te figura nën gj. dallimi i madhësive hyrëse e lëviz membranën së bashku me levën. Leva lëviz te poshtë dhe e mbyllë hapjen e gypit, me çka përcaktohet sasia e fluidit e cila del prej gypit. Domethënë dallimi i madhësive hyrëse e përcakton madhësinë dalëse të krahasuesit.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Pse krahasuesit kanë rol të rëndësishëm në sistemin e rregullimeve?
2. Shpjego parimin e punës së krahasuesve të dhënë në figurën 3.15?

## 3.9 ELEMENTET EKZEKUTIVE

Elementet ekzekutive kanë për detyrë të përcjellin veprimin e rregulatorit mbi objekt. Gjatë punës përdorin energji ndihmëse. Në varshmëri prej llojit të energjisë ndihmëse elementet ekzekutive mund të jenë: hidraulike, pneumatike dhe të kombinuara. Ato mundësojnë veprim përkatës të rregulatorit mbi

objektin nëse presioni i fluidit mbi pistonin ose membranën është mjaft i madh dhe nëse sipërfaqja e membranës ose pistonit është mjaft e madhe.




Fig. 3.16. Elementet ekzekutive

Në figurën nën a. është dhënë piston cilindrik me veprim të njëanshëm. Madhësia hyrëse e lëviz pistonin te poshtë. Së bashku me të lëviz edhe leva. Lëvizja e saj është madhësi dalëse nga elementi ekzekutiv. Kthyesen e ekzekuton spiralja. Në figurën nën b. është dhënë pistoni cilindrik me veprim të dyanshëm ku edhe punuesin edhe kthyesin e ekzekuton madhësia hyrëse. Lëvizja e levës është madhësi dalëse e elementit ekzekutiv. Në figurat nën g dhe d. janë të dhëna elementet ekzekutive membranore që punojnë mbi parimin e njëjtë si dhe pistonat e elementeve ekzekutive. Në figurën nën v. është dhënë elementi ekzekutiv termopneumatik. Nëpërmjet nxehësit 1 madhësia hyrëse e dërgon nxehësinë e ajrit në dhomëzën 2. Ajri përhapet nën ndikimin e nxehësisë dhe e vë në lëvizje membranën së bashku me levën. Lëvizja e levës është madhësi dalëse. Nëpërmjet nxehësit 1 mund të rrymon lëngë i nxehës, avull i nxehës ose prapë nxehësi mund të jetë elektrik.

Nga ajo që është paraqitur në këtë temë mund të shihet se elementet prej të cilave është i përbërë rregullatori mund të janë pneumatike, hidraulike dhe të kombinuar. Vëtitë e tyre pozitive janë: pandjeshmëria e vibracioneve, rezatimi, siguria në rast zjarri, mund të punojnë në kushte të rënda si për shembull në mjeshtëri lagësht, kanë mirëmbajtje të rëndomtë, kohë të gjatë të qëndrueshmërisë, precizitet të mjaftueshëm, saktësi dhe shpejtësi të përcjelljes së sinjalit. Duhet theksuar se rregullatorët mund të zbatohen si elektro-pneumatikë, elektrohidraulikë ose elektromagnetikë.

### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Cila është detyra e elementeve ekzekutive në sistemet e rregullimeve?
2. Shpjego parimin e punës së elementeve ekzekutive të dhënë në figurën 3.16?
3. Cilat veti i kanë elementet prej të cilave është përbërë rregulatori:

### **MBAJE MEND (REZYME):**

**Rregullimi** është proces me të cilin mbahet ndonjë madhësi në vlerën e saj të kërkuar. Procesi zhvillohet në sistemin e rregullimit.

**Sistemet e rregullimit (SAR)** janë sisteme te të cilët për formimin e udhëheqjes së drejtë të objektit përdoren informacione vetëm për shhangjen e sjelljes së tij të vërtetë nga sjellja e tij e kërkuar.

Sistemi i rregullimit përbëhet prej rregulatorit dhe objektit. Vlerat e vërteta dhe të kërkuarat të madhësisë së rregulluar janë madhësitë hyrëse në rregulatorë. Në bazë të atyre informacioneve rregulatori formon madhësi rregulative e cila është madhësi hyrëse në objekt. Ajo është bazë mbi të cilën zhvillohet procesi në objekt që madhësia e rregulluar ta fitoj vlerën e kërkuar.

Rregulatori(rregulluesi) dhe objekti kanë organet (pjesët) e veta të cilat mundësojnë të zbatohet rregullacioni.

#### **Organet e rregulatorit janë:**

- Dhënësi
- Elementi matës
- Krahasuesi
- Organet korrektuese përcjellëse
- Organi ekzekutiv i rregulatorit

#### **Organe të objektit janë:**

- Organet rregulative të objektit
- Pjesa e punës së objektit

Pjesët nga të cilët janë të përbërë rregulatorët dhe objekti mund të janë pneumatike, hidraulike dhe të kombinuara. Ato kanë më shumë veti pozitive siç janë: mirëmbajtja e thjeshtë, kohëzgjatja e qëndrueshmërisë, precizitet i mjaftueshëm, saktësi dhe shpejtësi e përcjelljes së sinjalit për shkak të së cilëve zbatohen edhe sistemet e rregullacionit.

## 4. RREGULLIMI I MADHËSIVE TË PROCESEVE

Mbi objekt gjatë zhvillimit të proceseve mund të veprojnë çrregullime të paparashikuara të cilat mund të janë të ndryshme sipas fortësisë dhe të cilat veprojnë një kohë më të shkurtë ose më gjatë. Ato shkaktojnë ndryshime të madhësive të ndryshme në proces. Për këtë shkak patjetër të rregullohen madhësitë të cilat janë të rëndësishme për proceset.

### 4.1. RREGULLIMI I PRESIONIT

Rregullimi automatik i presionit zbatohet me rregulator i cili mund të jetë rregulator me veprim direkt dhe rregulator me veprim indirekt. Te të dy llojet e rregulatorëve për rregullimin e presionit shfrytëzohet informacion për vlerën momentale dhe të vërtetë të presionit në objekt. Te të dy llojet e rregulatorëve vlera e kërkuar e presionit fitohet me ndryshimin e sasisë së gazit i cili sillet në rezervuar. Rregullimi i presionit mund të kryhet edhe me ndryshimin e sasisë së gazit i cili dërgohet në rezervuar, nëse valvoli vendoset në gypin e caktuar.

Rregullimi i presionit mund të kryhet edhe pa matjen dhe dhënien e sinjalit për presion në sistemin e rregullacionit. Kjo mund të kryhet nëpërmjet matjes së madhësive të tjera të cilat janë të varura nga presioni. Në rastin konkret ajo madhësi është rrjedhja.




Fig. 4.1. Rregullimi i presionit me matjen e rrjedhjes.

Në gypin përcjellës vendoset pendë. Rrjedhja e fluidit i cili kalon nëpër penda është proporcional me presionin e rezervuarit. Motori membranor M e lëviz levën vertikale. Nga të dy anët e membranës veprojnë presionet që i ka fluidi para dhe pas pendës. Me matjen e këtyre presioneve në esencë matet rrjedhja nëpër pendë. Nëse vjen deri te rritja e presionit të fluidit në rezervuar zhvendoset sistemi i levave (E do të vijë deri te pozita  $E_1$ , kurse A do të vijë në pozitën e  $A_1$ ). Valvoli i rregullacionit mbylljet, në rezervuar vjen sasi më e vogël e fluidit. Me këtë, presioni në rezervuar zvogëlohet dhe sillet në vlerën e kërkuar.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Në bazë të të cilave informacione rregullohet presioni te rregulatorët me veprim direkt dhe indirekt? Shpjego rregullacionin te të dy rregulatorët?
2. Shpjego mënyrën e rregullimit të presionit i cili kryhet pa matje të presionit dhe të dy sinjaleve për të?

#### 4. 2. RREGULLIMI I RRJEDHJES

Rregullimi i rrjedhjes së lëngut i cili rrjedh nga rezervuari bëhet në mënyrën vijuese:




Fig. 4.2. Rregullimi i rrjedhjes

Në gypin dalës vendoset elementi matës për rrjedhën 2. Sinjali për matjen e rrjedhjes sillet në elementin përcjellës PO, ku krahasohet me sinjalin për vlerën e dhënë të rrjedhjes i cili vjen nga dhënësi 1. Në organin transmetues sillet edhe sinjali për lartësinë e lëngshmërisë në rezervuar, për shkak se ndryshimi i lartësisë së lëngshmërisë në rezervuar ndikon mbi rrjedhën. Në bazë të këtyre tri sinjaleve organi transmetues formon madhësi drejtuese e cila

dërgohet deri te motori M i cili e hap dhe e mbyll valvolin 4. Me hapjen ose me mbylljen e valvoltit rrjedhja sillet në vlerën e kërkuar.

Diagrami strukturor i këtij elementi është dhënë në figurën 4.3.




Fig. 4.3 Diagrami strukturor për sistemin e rregullimit të rrjedhjes

Ky sistem për rregullim i përban elementet vijuese:

- 1 – dhënësin
- 2 – elementin matës për rrjedhje
- 3 - elementin matës për nivelin e lëngut (të çrrregullimeve)
- 4 – organin drejtues të objektit
- 5 – pjesën e punës së objektit

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat informacione janë të nevojshme për rregullimin e rrjedhjes?
2. Shpjego mënyrën e rregullimit të rrjedhjes?
3. Vizato diagramin strukturor të sistemit për rregullimin e rrjedhjes dhe identifiko pjesët dhe madhësitë e tij?

### 4. 3. RREGULLIMI I NIVELIT TË LËNGUT

Rregullimi i nivelit të lëngut mund të jetë rregullim direkt tek i cili, elementi matës i energjisë është i mjaftueshëm për lëvizjen e organit rregullativ ose ndryshe thënë rregullim indirekt tek i cili përdoret energjia ndihmëse për lëvizjen e organit rregullativ. Rregullacioni direkt i nivelit të lëngut paraprakisht është shpjeguar në figurën 3.3. Në figurën 4.4 është dhënë rregullacioni indirekt i nivelit të lëngut.

Duhet të mbahet niveli konstant i lëngut në rezervuarin 9. Ndryshimi i rrjedhjes  $q_1$  do të ndryshojë nivelin e lëngut në rezervuar. Rrjedhja  $q_1$  matet me pendën 3 dhe motorin hidraulik 4.




Figura 4.4 Rregullacioni i nivelit të lëngut

Me vidhën 1 dhe spiralen 2 jepet vlera e kërkuar e nivelit të ujit në rezervuar. Nëse vjen deri te rritja e nivelit të ujit në rezervuar atëherë rritet presioni mbi pistonin në motorin 4. Pistoni lëviz te poshtë së bashku me levën dhe e tërheq skajin e majtë të levës 5. Skaji i djathtë i levës 5 i tërheq pistonat lartë nga shpërndarësi 6. Vaji me rrjedhë  $Q$  nëpër kanalin e sipërm vjen nga ana e sipërme e pistonit në motorin hidraulik 7, e shtyp pistonin te poshtë me çka hapet valvoli 8. Nga rezervuari dërgohet sasi më e madhe ujit me ç'rast niveli në rezervuar zvogëlohet.

Për zmadhimin e nivelit të rezervuarit është e nevojshme që me anë të vidhës më shumë të shtrëngohet spiralja. Me këtë pistonat në shpërndarësin 6 do të lëshohen te poshtë. Vaji do të vjen deri te ana e poshtme e pistonit 7 me çka valvoli 8 do të mbyllët. Nga rezervuari dërgohet sasi më e vogël e ujit, ndërsa me këtë niveli i ujit në rezervuar do të rritet.

Diagrami strukturor i këtij sistemi është dhënë në figurën 4.5.




Figura 4.5 Diagrami strukturor i sistemeve për rregullimin e nivelit të lëngut

Ky sistem për rregullim i përmban elementet vijuese:

- 1 dhe 2 – dhënësit
- 3 dhe 4 – elementin matës
- 5 – mbledhësin
- 6 – shndërruesin dhe përforcuesin
- 7 – organin ekzekutiv të sistemit drejtues
- 8 – organin drejtues të objektit
- 9 – pjesës punuese të objektit

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat informacione përdoren për rregullimin e nivelit të lëngut në rezervuar?
1. Shpjego mënyrën e rregullimin të nivelit të lëngut?
2. Vizato diagramin strukturor të sistemit për rregullim e nivelit të lëngut dhe identifikoi pjesët dhe madhësitë e tij.

#### 4.4 RREGULLIMI I TEMPERATURËS




Fig. 4.6 Rregullimi i temperaturës

Është e nevojshme që temperatura të mbahet konstante e ujit në rezervuarin 8. Nga gypi i lartë vjen uji me temperaturë  $t_1$  dhe presion  $q_1$ . Nga gypi i poshtëm vjen ujë me temperaturë  $t_2$  dhe rrijedhë  $q_2$ , pastaj  $t_1 < t_2$ . Në gypin e sipërm është vendosur penda 1, informacioni për rrjedhjen e matur vjen në transmetuesin 2 i cili ka për detyrë të përforcoj informacionin dhe të dërgoj atë te mbledhësi 3. Dhënësi 4 dërgon informacione në mbledhësin 3 për vlerën e

Kërkuar të temperaturës së ujit në rezervuarin 8. Në bazë të atyre dy informacioneve mbledhësi formon informacion të cilin e dërgon në organin përcjellës 5, ndërsa pastaj në motorin 6. Motori pneumatik 6 në bazë të informacioneve të fituara e hap ose e mbyll valvolin rregulator 7. Ndryshimi i temperaturës së ujit në rezervuar mund të ndodh gjatë ndryshimit të rrjedhës  $q_1$  dhe  $q_2$ , me çka paraqet zgjerim të këtij sistemi. Nëse vjen deri te zmadhimi i temperaturës së ujit në rezervuar, motori 6 e mbyll valvolin 7, në rezervuar vjen sasi më e vogël e ujit të ngrohtë me çka zgjedhet temperatura e ujit në rezervuar. Nëse temperatura e ujit në rezervuar zgjedhet, motori 6 e hap valvolin 7, në rezervuar vjen sasi më e madhe e ujit të ngrohtë me çka temperatura e ujit në rezervuar zmadhohet.

Diagrami strukturor i këtij sistemi është dhënë në figurën 4.7.




Fig. 4.7. Diagrami strukturor i sistemit për rregullimin e temperaturës

Ky sistem për rregullim i përban elementet vijuese:

- 1 – elementin matës për rrjedhën
- 2 – përforcuesin
- 3 - mbledhësin
- 4 – dhënësin
- 5 – përforcuesin dhe shndërruesin
- 6 – organin ekzekutiv të sistemit drejtues
- 7 – organet drejtuese të objektit
- 8 – pjesë punuese të objektit

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat informacione janë të nevojshme për rregullimin e temperaturës së ujit në rezervuar?
2. Shpjego mënyrën e rregullimit të temperaturës së ujit në rezervuar?
3. Vizato diagramin strukturor të sistemit për rregullimin e temperaturës dhe identifiko pjesët dhe madhësitë e tij.

#### 4.5. RREGULLIMI I SASISË SË KARBURANTIT

Te disa procese është e nevojshme që karburanti të vjen në sasi të caktuar në njësinë e kohës. Për këtë qëllim është e nevojshme që të rregullohet sasia e karburantit, ndërsa ajo bëhet në mënyrën vijuese:




Fig. 4.8 Sistemi për rregullimin e sasisë së karburantit

Në këtë figurën është dhënë skema për rregullimin e sasisë së karburantit e cila përcillet me transportues dhe e cila lëviz me shpejtësi konstante. Rrëshqitësi 1 e ndryshon pozitën e tij gjatë ndryshimit të sasisë së karburantit që e përcjell transportuesi. Nëse zmadhohet sasia e karburantit (zmadhohet lartësia e tij) leva 6 së bashku me pistonat nga shpërndarësi 2 lëviz lartë. Vaji nga shpërndarësi 2 nëpërmjet kanalit të sipërm vjen nga ana e përparme e pistonit në motorin 3. E zhvendos pistonin majtas, ndërsa më këtë zhvendoset edhe pllaka 4. Në këtë mënyrë zvogëlohet sasia karburantit e cila vjen në transportues.

Diagrami strukturor i këtij sistemi është dhënë në figurën 4.9.




Fig. 4.9 Diagrami strukturor i sistemit për rregullimin e sasisë së karburantit

Ky sistem për rregullacion i përmban elementet vijuese:

- 1 – elementin matës
- 2 – krahasuesin
- 3 – organin ekzekutiv të rregulatorit
- 4 – organin rregullativ të objektit
- 5 – pjesën e punës së objektit
- 6 – dhënësin, krahasuesin dhe shndërruesin

#### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Cilat informacione janë të nevojshme për rregullimin e sasisë së karburantit?
2. Shpjego mënyrën e rregullimit të sasisë së karburantit?
3. Vizato diagramin strukturor të sistemit për rregullim e sasisë së karburantit dhe identifiko pjesët dhe madhësitë e tij.

#### **MBAJE MEND (REZYME)**

Gjatë zhvillimit të proceseve të instalimeve, veprojnë çrregullime të ndryshme të cilat shkaktojnë ndryshime të madhësive të proceseve. Për këtë shkak në sisteme ekzistojnë qarqe të rregullacionit me të cilat rregullohen madhësitë dhe me anë të të cilave arrihet deri te vlera e kërkuar.

Rregullimi i presionit mund të zbatohet me matjen e vlerës momentale të presionit, ose me matjen e vlerës së madhësisë tjetër e cila është e lidhur me presionin.

Rregullimi i rrjedhës zbatohet me përdorimin e informacioneve për vlerën momentale dhe të kërkuar të rrjedhjes dhe informacionit për nivelin e ujit në rezervuar (çrregullimit) sepse ai ndikon mbi rrjedhën.

Rregullacioni i nivelit të lëngut mund të jetë direkt ose indirekt në varshmëri të energjisë së elementit matës.

Rregullacioni i temperaturës së ujit në rezervuar bëhet me shfrytëzimin e informacionit të rrjedhjes së ujit më të ftohët i cili vjen në rezervuar dhe informacionit për vlerën e kërkuar të temperaturës së ujit në rezervuar.

Sasia e karburantit e cila përcillet me anë të transportit, rregullohet me shfrytëzimin e informacionit për verën e kërkuar dhe të vërtetë të sasisë së karburantit.

Gjatë rregullimit të këtyre madhësive kërkohet dhënësi, elementet matëse, shndërruesi, përforcuesi, elementet ekzekutive të cilët janë të lidhura ndërmjet veti dhe të cilët e ekzekutojnë funksionin e vetë dhe i sjellin madhësitë deri te vlerat e tyre të kërkuara.

## **5. RREGULLIMI I INSTALIMEVE**

### **5.1. RREGULLIMI I KAZANËVE DHE INSTALIMEVE TË KAZANËVE**

Kur bëjmë fjalë për rregullimin e kazanëve, kazanin patjetër ta vështrojmë si objekt të rregullacionit. Për këtë shkak është e nevojshme të definohen madhësitë hyrëse dhe dalëse dhe çrrregullimet të cilat veprojnë mbi objektin. Te instalimet e këtilla të përbëra, kurse me vetë këtë edhe të objekteve të ndërlikuara, në të cilat ndodhin ndryshime të madhësive të ndryshme fizike kryhet thjeshtëzimi i procesit që të mund analizohen elementet themelore, varshmëritë e tyre ndërmjet veti dhe ndikimet ndërmjet tyre.

Në secilin kazan ekzistojnë dy qarqe(rrethe) themelore rregullative:

**1. Rrethi i karburantit dhe ajri i nevojshëm për djegie**

**2. Rrethi i ujit të mbushur i cili nxehet, avullohet dhe nxehet me ngrohtësinë e çliruar gjatë djegies.**

Që të sigurohen të gjitha proceset në instalimin e kazanit ekzistojnë shumë rrethe të tjera individuale me udhëheqje të posaçme të organeve nga rrethi (valvola, pompa, ventilatorë, zile, rezervuarë, djegës, ngrohës etj.). Të gjitha këto me punën e tyre mundësojnë nxehje, avullim dhe ngrohje të avullit ujor me mbajtjen e presionit dhe temperaturës konstante.

Meqenëse konsumi i avullit ndryshon atëherë ai shkakton ndryshim të presionit dhe të temperaturës. Me kyçjen e rretheve individuale të rregullacionit në instalimet e kazanit këto madhësi sillen në vlerën e kërkuar. Nëse ndryshimi i presionit dhe temperaturës është aq i madh që t'i tejkaloj kufijtë e paraparë me projektim, atëherë sistemet e rregullimit nuk do të mund të kryejnë rregullimin, ndërsa edhe elementet e sistemit të cilët janë të projektuara me parametra të caktuar nuk do të mund të durojnë. Në rastin e këtillë kyçet sistemi për sinjalizim dhe mbrojtje. Ky sistem ka për qëllim që ta njoftoj udhëheqësin për situatën e krijuar, ndërsa kur edhe ai nuk është në gjendje të vepoj atëherë vepron sistemi për mbrojtje dhe e pengon dëmtimin e instalimit.

Nëse instalimin e kazanit e vështrojmë nga aspekti i rregullacionit, ai paraqet sistem i cili ka madhësi hyrëse dhe dalëse të çrrregullimeve. Instalimi i kazanit dhe madhësitë e të cilët janë karakteristike për të, janë dhënë në figurën 5.1.




Fig. 5.1 Tregimi simbolik i sistemit

p – presioni i avullit

t – temperatura e avullit

Presioni dhe temperatura janë madhësi rregulluese. Sistemi i rregullimit ka për detyrë që ato të ruaj në mënyrë konstante.

$H_d$  – fuqia e ngrëhtësisë së karburantit

$t_v$  – temperatura e ajrit e cila sillet për djegie

$t_w$  - temperatura e ujit të mbushur

y – ndryshimi i konsumit të avullit

Madhësitë e paraqitura çrrregullohen në sistem. Me ndryshimin e tyre vjen deri në ndryshimet e presionit dhe të temperaturës.

G – sasia e karburantit

$q_{dg}$  – rrjedhja e tymit të gazrave

$q_v$  – rrjedhja e ajrit

$q_w$  – rrjedhja e ujit

$q_{ww}$  – rrjedhja e ujit për injektim (gjatë rregullimit të temperaturës)

Elementet e paraqitura janë madhësi rregullative të cilët ndikojnë mbi sjelljen e sistemit.

Për realizimin e qëllimit kryesor, rruajtjen e presionit dhe temperaturës konstante, në të njëjtën kohë veprojnë të gjitha rrethet e pavarura të cilat e rregullojnë: procesin e djegies, procesin e mbushjes, temperaturën, presionin. Këto rrethe individuale ndërmjet tyre janë të lidhura dhe ndikojnë njëri mbi tjeterin si dhe ndryshojnë disa madhësi të cilat nuk është e thënë të jenë madhësi dalëse nga tërë sistemi.

### PYETJE DHE DETYRA:

1. Pse kryhet rregullacioni i kazanëve?
2. Cilat rrethe të rregullacionit ekzistojnë për rregullimin e kazanëve dhe instalimeve të kazanëve?
3. Analizo madhësitë hyrëse dhe dalëse dhe çrrregullimet e instalimeve të kazanit?

### 5.1.1. RREGULLIMI I UJIT TË MBUSHUR




Fig. 5.2. Rregullimi i ujit të mbushur

Në figurë është dhënë skema për rregullimin e ujit të mbushur te kazanët e avullit. Rregulatori e pranon sinjalin nga elementi matës 2 për nivelin e ujit në kazan, nga elementi matës 3 për sasinë e ujit të mbushur dhe nga elementi matës 4 për presionin e avullit para hyrjes së avullit kryesor. Në bazë të këtyre sinjaleve rregulatori formon sinjal të cilin e dërgon deri tek elektromagneti 5 i cili nëpërmjet servomotorit 6 e hap ose e mbyll valvolin 7. Me këtë në kazan hynë sasi e nevojshme e mbushjes së ujit.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cilat informacione i shfrytëzon rregulatori gjatë rregullimit të ujit të mbushur te kazanët e avullit?
2. Shpjego mënyrën e rregullimit të ujit të mbushur te kazanët e ujit?

## 5.1.2 RREGULLIMI I TEMPERATURËS SË AVULLIT

Ekzistojnë më shumë mënyra të rregullimit të temperaturës së avullit te kazanët e avullit. Më shpesh përdoren tri llojet vijuese të rregullacionit:

**1. me rregullacionin e sasisë së gazrave të tymosura që sillen te nxehësit e avullit**

**2. me ftohje të sasisë së caktuar të avullit**

**3. me injektimin e ujit në avull**

1. Gjatë mënyrës së parë të rregullacionit elementi matës për temperaturë, jep sinjal për lëvizjen e kapitjes me anë të cilët rregullohet sasia e gazrave të tymosura. Me mbylljen e saj zmadhohet ose zvogëlohet sasia e gazrave të tymosura të cilat e nxehin avullin. Ajo mbyllet aq, sa është e nevojshme që temperatura e avullit në dalje nga nxehësi ta arrij vlerën e kërkuar.

2. Mënyra e dytë e rregullacionit zbatohet në mënyrën vijuese:





Fig. 5.3. Rregullacioni i temperaturës së avullit me ftohjen e sasisë së caktuar të avullit

Avulli prej kazanit shkon në nxehësin  $P_1$  dhe nëpërmjet valvolit  $V$  në nxehësin  $P_2$  dhe pastaj në avullin kryesor drejt konsumuesve. Një pjesë e tij gjendet në gyp, fillimi i të cilët gjendet ndërmjet valvolit  $V$  dhe elementit matës TE, ndërsa fundi i tij gjendet në valvolin  $V$ . Pjesa e përdredhur e gypit gjendet në ujin e kazanit. Nëse temperatura e avullit nga ngrohësi  $P_1$  zmadhohet, elementi matës TE dërgon sinjal në rregulatorin  $R$ , ndërsa ai dërgon sinjal deri te

servomotori M i cili e hap valvolin. Sasia më e madhe e avullit vjen në kazan, ftohet dhe përsëri kthehet para elementit matës TE, ku matet temperatura. Valvoli do të jetë i hapur gjithnjë deri sa nuk arrihet temperatura e kërkuar e avullit. Temperatura e avullit në përcuesin e avullit kryesor e kontrollon elementin matës GTE dhe dërgon sinjal për të deri te rregullatori.

3. Mënyra e tretë e rregullimit zbatohet në mënyrën vijuese:




*Fig 5.4. Rregullacioni i temperaturës së avullit me futje të ujit në avull*

Avulli prej kazanit shkon te ngrohësi  $P_1$  pastaj në dhomëzën për ftohje H, në ngrohësin  $P_2$  dhe në përcjellësin e avullit kryesor drejt konsumuesit. Elementet matëse RTE dhe TE dërgojnë sinjal për temperaturën e avullit në pranuesin e sinjalit PI dhe rregullatorin R. Në varshmëri nga sinjalet e fituara rregullatori dërgon sinjal deri te servomotori M për aktivizimin e valvolit V. Nëse temperatura e avullit zmadhohet, valvoli hapet dhe futet ujë në avull në dhomëzat për ftohje. Gjatë futjes shfrytëzohet kondensat që të mos formohet shtresë prej bigorri në kanale dhe në ftohës. Valvoli do të jetë i hapur për deri sa të arrihet temperatura e kërkuar e avullit.

### PYETJE DHE DETYRA:

1. Në çfarë mënyre mund të rregullohet temperatura e avullit te kazanët e avullit?
2. Shpjego mënyrat për rregullimin e temperaturës së avullit?

### 5.1.3 RREGULLIMI I NDEZJES



*Fig. 5.5 Rregullimi i ndezjes*

Në figurë është dhënë skema e rregullimit të ndezjes. Ajo zbatohet në tri rregulatorë 1,2 dhe 3. Ato rregulatorë nga elementet matëse pranojnë sinjale për presionin e avullit 4, dendësinë e gazrave të tymosura 5 dhe presionin e ajrit në kanalin përcues 6. Rregulatorët dërgojnë sinjale deri te releji elektrohidraulik 7 i cili pranon ujë prej valvolit 8. Uji sasia e të cilit i përgjigjet sinjaleve të pranuara dërgohet deri te servomotori 9 të cilin e lëvizin kapitjet 10,11,12. Me lëvizjen e tyre rregullohet sasia e ajrit, sasia e karburantit dhe sasia e gazrave të tymosura.

### PYETJE DHE DETYRA:

1. Shpjego mënyrën e rregullimit të ndezjes së kazanëve të avullit?
2. Cilat informacione përdoren për rregullimin e ndezjes dhe cilat madhësi rregullohen?

### 5.1.4 RREGULLIMI I NËNPRESIONIT NË NDEZJEN

Detyra themelore gjatë rregullimit të presionit të avullit është mbajtja e marrëdhënies së vazhdueshme ndërmjet ngarkimit të kazanit dhe turbinës. Ky rapport mbahet vetëm atëherë kur kazani prodhon aq avull sa është e nevojshme për turbinën. Ajo arrihet me më shumë rrethe rregulative të cilat ndërmjet veti janë të lidhura dhe varen njëri prej tjetrit. Rregullimi i këtillë me emrin e përbashkët quhet rregullim i nënpresionit në ndezjet.




Fig. 5.6. Rregullimi i nënpresionit në ndezjet

Në rregulatorin 1 vjen sinjali për presionin e avullit i cili dërgohet deri te rregulatori 2. Në rregulatorin 2 vijnë edhe sinjale me rrjedhjen e avullit i cili matet me elementet 10 dhe sinjalin për presion të avullit në kazanin 14. Rregulatori 2 mbi bazën e këtyre sinjaleve të cilët i dërgon deri te rregulatori 5 në të cilin vjen edhe informacioni për presionin e gazrave të tymosura që vijnë deri te elementi 11. Në bazë të këtyre dy informacioneve rregulatori 5 dërgon sinjal deri te servomotori 12 dhe në varshmëri prej sinjalit lëshohet sasi e caktuar e karburantit në ndezje. Për djegien e karburantit është e nevojshme sasi e caktuar e ajrit. Ai sigurohet në bazë të sinjaleve për presionin e avullit i cili vjen prej rregulatorit 1 dhe presionit të rrymimit i cili vjen nga elementi 13.

Të dy informacionet vijnë në rregulatorin 3 i cili në bazë të tyre dërgon sinjal deri te servomotori 12 që e vë në lëvizje ventilatorin 8. Ai siguron sasi të mjaftueshme të ajrit për djegien e lëndës djegëse. Elementi 7 kryen rregullimin e temperaturës së avullit. Në varshmëri nga puna ndezjes ndryshon edhe dendësia e gazrave të tymosura. Rregullimi i tyre kryhet në rregulatorin 4. Nga ana e elementit matës 6 fitohet informacion për dendësinë e gazrave të tymosura të cilat dërgohen deri te servomotori 12 i cili e kyç ose ç'kyç ventilatorin 9. Me këtë rregullohet dendësia e gazrave të tymosura. Sasia e avullit që vjen në turbinë rregullohet me rregulatorin 16. Elementi matës 15 dërgon informacion për numrin e rrotullimeve në turbinë deri te rregulatori 16 dhe në bazë të atij informacioni hapet ose mbyllët valvoli 17. Me këtë rregullohet sasia e avullit që vjen në turbinë.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cili është qëllimi i rregullacionit të nënpresionit në ndezje?
2. Cilat rrethe rregullative shfrytëzohen gjatë rregullimit të nënpresionit në ndezje?
3. Shpjego mënyrën e rregullimit të nënpresionit në ndezje?

## 5.2. RREGULLIMI I TURBINAVE TË AVULLIT

Rregullimi te turbinat e avullit ka për detyrë që fuqinë e turbinave ta përshtat ndaj mbingarkimit të jashtëm dhe me këtë të mban numrin konstant të rrotullimeve në rrotullues. Rregullacioni mund të kryhet në tri mënyra:

1. **Rregullimi sasior** me të cilin ndryshon sasia e avullit që shkon në turbina.
2. **Rregullimi kualitativ** (rregullacioni me zënien e frysës) me të cilin lëshohet avull me çka ndryshojnë parametrat e tij – presioni dhe rënia e tij.
3. **Rregullimi i kombinuar** i cili është kombinim i dy rregullacioneve të mëparshme.

1. **Rregullimi sasior.** (fig. 57). Reaktivët ndahen në disa grupe dhe secili grup e ka valvolin e vet. Gjatë hapjes nominale të turbinës të gjitha valvolat janë plotësisht të hapur. Kur zvogëlohet mbingarkimi i turbinës valvolat në mënyrë të renditur fillojnë të mbyllen, edhe atë së pari valvoli  $V_4$ , kurse pastaj valvolat  $V_3$ ,  $V_2$ ,  $V_1$ . Me këtë zvogëlohet sasia e avullit që vjen në turbinë dhe fillon të zvogëlohet numri i rrotullimeve në bosht.




Fig. 5.7 Regullimi sasior




Fig. 5.8. Regullimi kualitativ




Fig. 5.9. Regullimi i kombinuar

**2. Rregullimi kualitativ.** (fig. 5.8) Avulli sillet në turbinë nëpërmjet valvolit ngulfatës deri te të gjithë reaktivët në të njëjtën kohë. Gjatë fuqisë nominale valvoli ngulfatës është plotësisht i hapur. Kur zvogëlohet ngarkimi i valvolit ngulfatës ai mbyllet dhe e zvogëlon hapësirën nëpër të cilin kalon avulli. Kur avulli kalon prej prerjes së tèrthortë më të vogël në atë më të madhe, shpejtësia e tij zvogëlohet, kurse zvogëlohet edhe presioni. Në turbinë avulli hynë me presion më të vogël, kurse me këtë zvogëlohet edhe numri i rrotullimeve në turbinë.

**3. Rregullimi i kombinuar.** (fig.5.9). Ky rregullim është kombinacion nga dy rregullimet e mëparshme. Në fillim aplikohet rregullacioni me ngulfatës (përafërsisht deri te gjysma e ngarkimit), kurse pastaj aplikohet rregullacioni me aplikimin të sasisë së avullit. Avulli i cili shkon në reaktivët e grupit të katërt vetëm ngulfatet, kurse avulli nga grupei i parë, i dytë dhe i tretë i reaktivëve edhe ngulfatet edhe zvogëlohet sasia e tij.

Secila turbinë duhet të ketë rregulatorë të sigurisë. Ai më shpesh është vendosur në rrathët e turbinës para shtratit(shtresës) të përparmë. Ka përditësje që ta ndërpresë dërgesën e avullit në turbinë kur do të vjen deri te rritja e shpejtë e numrit të rrotullimeve të turbinës. Rregulatori kyçet kur numri i rrotullimeve të turbinë zmadhohet 10 deri në 15%.




Fig. 5.10 Rregulatori i sigurisë

Rregullimi kryhet në mënyrën vijuese. Spiralja 1 është e rregulluar sipas numrit maksimal të rrotullimeve në rrathët e turbinës. Kur numri i rrotullimeve do të rritet mbi maksimumin e lejuar atëherë fitohet fuqia në spirale. Unaza 2 e cila është e vendosur në mënyrë ekscentrike në boshtin 3 të turbinës do të lëviz te poshtë. Me këtë do të lëviz leva e dyfishtë 4 (pjesa horizontale te poshtë, kurse pjesa vertikale djathtas). Do të lirohen levat 5,6, dhe 7 të cilat e lirojnë levën 8, kurse ajo e liron pllakën 9. Nën veprimin spirales së tjerhequr 10, pllaka 9 lëviz te poshtë, valvoli 11 do të mbyllë dhe do ta ndërpresë dërgimin e avullit në turbinë. Dorëza 14 shërben për lëvizjen me dorë të valvoltit.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Në çfarë mënyre mund të kryhet rregullimi i turbinave të avullit?
2. Shpjego mënyrat e rregullimit të turbinave të avullit?
3. Cila është detyra e rregulatorit të sigurisë dhe kur ai vepron?
4. Shpjego mënyrën e veprimit të rregulatorit të sigurisë?

## 5.2. 1 RREGULLIMI DIREKT DHE INDIREKT TE TURBINAT E AVULLIT

Numri i rrotullimeve te turbinat e avullit më së shpeshti rregullohet me rregulatorin centrifugal. Veprimi i tij varet nga ndryshimi i numrit të rrotullimeve. Rregullimi me anë të rregulatorit të këtillë mund të jetë **direkt dhe indirekt**.

**Rregullimi direkt** përdoret për trupat e vegjël dhe kur rezistuesit që duhet t'i zotëroj valvoli nëpër avull janë të vegjël. Te ky lloji i rregullacionit, veprimi i rregulatorit centrifugal direkt përcillet mbi valvolin.

Rregullacioni indirekt përdoret për trupat e mëdhenj dhe atëherë kur është e nevojshme të mbizotërohen rezistuesë të mëdhenj gjatë zhvendosjes së valvolit nëpër avull. Te ky lloj i rregullacionit, sistemi përmban servomotorin dhe shpërndarësin. Energjia ndihmëse e vajit shfrytëzohet për zotërimin e rezistuesve. Ky rregullacion mund të jetë **me lidhje kthyese dhe pa lidhje kthyese**. Të dy sistemet dallohen në strukturën e lidhjeve. Në sistemin pa lidhje kthyese të shpërndarësit vepron vetëm rregulatori. Në sistemet me lidhje kthyese, në lidhje mbi shpërndarësin veprojnë rregulatorët centrifugalë dhe servomotori.

Rregullimi i turbinave të avullit në mënyrë skematike është dhënë në figurë:




Fig. 5.11. Rregullimi i turbinave të avullit

Rregullimi bëhet në mënyrën vijuese. Me vidhen dhe spiralen jepet numri i kërkuar i rrotullimeve të turbinës. Me këtë leva 2 dhe masat në rregulatorin centrifugal 11 kanë pozitë të përcaktuar. Rregulatori nëpërmjet çiftit dhëmbëzor 10 është i lidhur me boshtin e turbinës. Nëse zmadhohet numri i rrotullimeve në turbinë masat e rregulatorit zgjerohen dhe e ngrenë levën 2. Leva i ngre pistonat në shpërndarësin 3 dhe vaji nëpërmjet vrimës së sipërme vjen nga ana e sipërme e pistonit në motorin 4. E shtyp pistonin te poshtë me çka vjen deri te mbyllja e valvolit 8, me këtë zvogëlohet sasia e avullit e cila vjen në turbinë dhe zvogëlohet numri i rrotullimeve në bosht. Spiralja 5, sasia ngulfatëse e vajit 6 dhe leva 7 janë organe korrekta. Kanë për detyrë të sigurojnë sjellje të mirë dinamike në turbinë.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Çfarë rregulatori më shpesh përdoret në turbinat e avullit?
2. Kur përdoret rregullacioni direkt, dhe kur indirekt te turbinat e avullit?
3. Shpjego mënyrën e rregullimit të turbinave të avullit me rregulator centrifugal.

### 5.3. RREGULLIMI I TURBINAVE TË UJIT

Rregullimi i turbinave të ujit bëhet me qëllim që të ruhet numri konstant i rrotullimeve në boshtin e turbinës gjatë ngarkimeve të ndryshme. Është e nevojshme të vendoset baraspeshë ndërmjet trupit të turbinës dhe ngarkimit. Meqenëse trupi i turbinës është proporcional me rrjedhën, rregullimi i turbinave të ujit bëhet me ndryshimin e rrjedhjes së ujit i cili vjen në turbinë.

#### 5.3.1. RREGULLIMI I TURBINËS SË PELTONOVIT (BELBËZUESE B.S!)




Fig 5.12. Rregullimi te turbina e Peltonovit

Te këto turbina rregullacioni bëhet me ndryshimin e rrjedhjes së ujit që vjen prej turbinave dhe me vënien në lëvizje të urorit dhe reaktivit (fiskajës. Gjatë zmadhimit të numrit të rrotullimeve në turbinë masat e rregulatorit 7 do të zgjerohen dhe do të ngrenë skajin e majtë të levës horizontale. Skaji i djathjtë i levës së bashku me pistonat e shpërndarësit 2 do të lëviz te poshtë. Vaji i shpërndarësit nëpërmjet vrimës së poshtme do të veproj mbi pistonin e motorit 1 dhe së bashku me levën do t'i lëviz ato në të djathjtë. Urori dhe reaktivi 9 do të lëvizin lartë. Me këtë rregulatori shpejtë do të reagoj. Nëpërmjet bregut 10 dhe sistemit prej levave 8 veprimi i rregulatorit përcillet mbi pistonat e shpërndarësit 4. Ato lëvizin poshtë dhe vaji i shpërndarësit nëpërmjet vrimës së poshtme vepron mbi pistonin e motorin 5. Pistoni së bashku me levën lëviz djathtas dhe vepron mbi reaktivin rregulator 6. Me këtë zvogëlohet sasia e ujit e cila vjen në turbinë dhe zvogëlohet numri i rrotullimeve në turbinë.

### 5.3.2 RREGULLIMI TE TURBINA E KAPLLANOVIT




Fig. 5.13 Rregullimi te turbina e Kapllanovit

Te këto turbina rregulatori duhet t'i vë në lëvizje lopatat e qarkut të punës (krahu i rotorit) dhe lopatat e statorit (lopatat e qarkut drejtues). Gjatë zmadhimit të numrit të rrotullimeve në turbinë masat e rregulatorit 11 do të zgjerohen dhe do ta ngrenë skajin e majtë të levës horizontale lartë. Skaji i djathjtë i levës fillon të lëviz te poshtë së bashku me pistonat e shpërndarësit 10. Vaji i shpërndarësit

nëpërmjet vrimës së poshtme vjen në motorin 6 dhe e vë në lëvizje pistonin së bashku me levën në të majtë. Me këtë lëvizin lopatat statorike. Ato rrotullohen rrëth boshtit të tyre që të zvogëlohet prerja e tërthortë nëpër të cilën kalon uji. Veprimi i rregullatorit nëpërmjet sistemit të levave, bregu 5 dhe leva 8 përcillen mbi pistonat e shpërndarësit 4. Ato lëvizin teposhtë, kurse vaji prej shpërndarësit nëpërmjet vrimës së poshtme vjen nga ana e sipërme e pistonit në motorin 3. Pistoni lëviz teposhtë dhe nëpërmjet levës vepron në rrotullimin e lopatave të qarkut të punës. Me rrotullimin e tyre zvogëlohet prerja e dredhur nëpër të cilin kalon uji. Në turbinë hynë sasi më e vogël e ujit me çka zvogëlohet numri i rrotullimeve në turbinë.

### 5.3.3 RREGULLIMI TE TURBINA E FRANSISOVIT




Fig. 5.14 Rregullimi te turbina e Fransisovit

Me vidhën 1 dhe spiralen 2 jepet numri i kërkuar i rrotullimeve në turbinë. Gjatë rritjes së numrit të rrotullimeve masat e rregullacionit 4 do të zgjerohen dhe do ta ngrenë skajin e djathtë të levës 5. Skaji i majtë i levës së bashku me pistonat e shpërndarësit 6 do të lëvizin te poshtë. Vaji vjen nga ana e sipërme e pistonit në motorin 7 dhe e lëviz atë te poshtë. Pistoni nëpërmjet sistemit të levave 8 e zvogëlon prerjen e tërthortë nëpër të cilën kalon uji. Në turbinë hynë sasi më e vogël e ujit, me çka zvogëlohet numri i rrotullimeve në turbinë. Veprimi i lidhjes kthyese realizohet nëpërmjet levës 10 dhe ngulfatësit elastik 11 dhe 12.

## PYETJE DHE DETYRA:

1. Cili është qëllimi i rregullimit te turbinat e ujit?
2. Cila madhësi rregullohet te turbinat e ujit?
3. Shpjego mënyrën e rregullimit te turbinat e Peltonovit, Kaplanovit dhe Fransosovit?

## 5.4. RREGULLIIMI I TURBINAVE TË GAZTA

Turbinat e gazit janë makina te të cilat shfrytëzohet energjia e gazzrave që fitohet me djegien e lëndëve djegëse. Kanë fuqi më të vogël nga turbinat e avullit. Përbëhen prej pjesëve vijuese: turbinës, kompresorit i cili e shtyp ajrin nën presion të dhomëzës për djegien e lëndës djegëse, motor për fuqi pune të kompresorit, dhomëza për djegien e lëndës djegëse në të cilën shpricohet lëndë djegëse dhe gjenerator të rrymës elektrike. Mund të jenë turbina të cilat punojnë në qark të hapur dhe turbina që punojnë në qark të mbyllur. Te turbinat e qarkut të hapur fluidi i punës gjatë procesit përtërihet, ndërsa te turbinat e qarkut të mbyllur procesi i punës zhvillohet në sasi të njëjtë të fluidit të punës. Te të dy llojet e turbinave rregullohet numri i rrotullimeve në turbinë me qëllim që ai të jetë konstant.

### 5.4.1 RREGULLIMI I TURBINAVE TË GAZTA NË QARKUN E HAPUR

Rregullimi i turbinave të gazit në qarkun e hapur mund të zbatohet në më shumë mënyra.

Rregullimi më i rëndomtë te turbinat e gazit zbatohet **me ndryshimin e sasisë së lëndës djegëse**. (fig. 5.15) Kjo e imponon nevojën e ndryshimit të sasisë së ajrit që e jep kompresori. Sasia e caktuar e ajrit merret prej shkallëve ndërmjet kompresorit dhe lëshohet ndërmjet shkallët së turbinës, nëpërmjet turbinës për presion të lartë dhe turbinës me presion të ulët.

Mënyra tjetër e rregullimit të turbinave të gazit është **me ngulfatje të ajrit para hyrjes së dhomëzës për djegie**. (fig. 5.16) Sistemi përbëhet prej dy boshteve. Në njërin është vendosur kompresori K dhe turbina për lëvizje të kompresorit  $T_k$ . Në boshtin tjetër është vendosur turbina për punët e dobishme  $T_{kop}$  dhe gjeneratori G. Me valvolin 1 rregullohet ajri që vjen në dhomëzën për djegie  $K_{o2}$  dhe rregullacioni i numrit të rrotullimeve në turbinë për punë të dobishme  $T_{kop}$ . Kur valvoli 1 është i mbyllur, hapet valvoli 2 dhe rregullohet ajri i cili vjen në dhomëzën për djegie  $K_{o1}$ . Me këtë rregullohet puna e kompresorit.




Fig. 5.15. Rregullimi me zbatimin e sasisë së lëndës djegëse




Fig. 5.16. Rregullimi me ngulfatje të ajrit




Fig. 5.17. Rregullimi me lëshimin e gazrave në atmosferë

Mënyra tjetër e rregullimit te këto turbina është **me lëshimin e gazrave në atmosferë**. (fig. 5.17) Sistemi ka dy boshte. Turbina për lëvizje të kompresorit është në njërin bosht, kurse turbina për punë të dobishme është në boshtin tjetër. Pjesa e gazrave që vjen nga turbina për lëvizje të kompresorit nëpërmjet valvolit lëshohen në atmosferë.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Në çfarë mënyre mund të rregullohen turbinat e gazit?
2. Shpjego mënyrat e rregullacionit të turbinave të gazit në qarkun e hapur?

#### 5.4.2 RREGULLIMI I TURBINAVE TË GAZIT NË QARKUN E MBYLLUR




Fig. 5.18 Rregullimi i turbinave të gazit në qarkun e mbyllur

Fluidi i punës te këto turbina është ajri. Kompresori K i cili vihet në lëvizje nga motori  $M_1$  e kompreson ajrin dhe e shtyp në këmbyesin e nxehësisë 5. Këtu ajri nxehet nga ajri që vjen nga turbina, kurse pastaj shkon në këmbyesin e nxehësisë  $K_o$  ku nxehet me djegien e lëndës djegëse. Kështu ajri i nxehur shkon në turbinën ku shfrytëzohet energjia e tij. Pas daljes nga turbina ajri kalon nëpër këmbyesin e nxehësisë 5, e dorëzon nxehësinë ajrit që vjen nga kompresori, shkon në kondensatorin 4, ftohet dhe përsëri kthehet në kompresor. Motori  $M_2$  e vë në lëvizje kompresorin  $K_o$  i cili nëpërmjet valvolit 1 e mbush rezervuarin R me ajër të kompresuar. Ajri i sistemi i cili humbet nëpër goditje, mbushet nga ky rezervuar me hapje të valvolit 2. Nëse është e

nevojshme të ritet numri i rrotullimeve të turbinës hapet valvoli 2, valvoli 3 është i mbyllur dhe në sistem hynë një sasi e konsiderueshme e ajrit. Nëse është e nevojshme të zvogëlohet numri i rrotullimeve në turbinë hapet valvoli 3, valvoli 2 është i mbyllur dhe në atmosferë lirohet sasi e konsiderueshme e ajrit. Nga kjo del se me anë të llojit të këtillë të rregullacionit sistemi mund të punoj pa probleme edhe me rastin e ngarkimit më të madh edhe më atë të vogël. Megjithatë çdo ngulfatje, rrjedhje ose rrethim në mënyrë jo të volitshme ndikon mbi shkallën e veprimit të dobishëm. Mu për këtë çështje, lloji i këtillë i rregullimit më rrallë përdoret.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Shpjego mënyrën e rregullimit të turbinave të gazta në qarkun e mbyllur?
2. Pse ky lloj i rregullacionit më rrallë përdoret?

### 5.5 RREGULLIMI I POMPAVE

Krahas asaj që pompa projektohet për kushte nominale të punës, gjatë ekspluatimit lajmërohet nevoja që pompa të jep sasi të ndryshme të lëngut. Për këtë shkak është e nevojshme të rregullohet rrjedhja e pompës.

Rrjedhja e pompës mund të rregullohet në dy mënyra:

- 1. Me ndryshimin e numrit të rrotullimeve**
- 2. Me ngulfatje**

#### 5.5.1 RREGULLIMI I POMPAVE ME NDRYSHIMIN E NUMRIT TË RROTULLIMEVE




Fig. 5.19 Rregullimi i pompave me ndryshimin e numrit të rrotullimeve

Pompa 5 është e vendosur në të njëjtin bosht me turbinën e avullit 4. Nëse rritet niveli i ujit në rezervuarin 1 pluskuesi 2 do të lëviz lartë dhe do ta hap valvolin 3. Në turbinë do të hyjë sasi më e madhe e avullit dhe do të rritet numri i rrotullimeve në turbinë. Meqenëse pompa dhe turbina janë në boshtin e njëjtë atëherë rritet edhe numri i rrotullimeve të pompës. Pompa do të thithë sasi më të madhe të lëngut nga rezervuari 1 dhe do ta shtyp rezervuarin 6. Ky rregullacion zbatohet drejtpërdrejtë me rregullimin e nivelit të ujit në rezervuar.

### 5.5.2 RREGULLIMI I POMPAVE ME NGULFATJE




Fig. 5.20 Rregullimi i pompave me ngulfatje

Ky lloj rregullacioni zbatohet kur pompa është e vendosur në boshtin e njëjtë me atë të elektromotorit. Meqenëse elektromotori mbushet nga rrjeti me tension dhe frekuencë konstante, nuk mund të kryhet ndryshimi i numrit të rrotullimeve në pompë. Në rastet e këtilla zbatohet rregullacioni me ngulfatje. Nëse rritet niveli i lëngut në rezervuarin 1, pluskuesi së bashku me skajin e majtë të levës do të lëviz poshtë dhe do të hapet valvoli 3. Me këtë pompa shtyp sasi më të madhe të lëngut në rezervuarin 6 dhe niveli i lëngut në rezervuarin 1 do të zvogëlohet.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Në çfarë mënyre mund të rregullohet rrjedhja te pompat?
2. Shpjego mënyrat e rregullimit te pompat?

## 5.6 RREGULLIMI I KOMPRESORËVE

Konsumi i ajrit më shpesh është i parashikueshëm dhe për atë rregullimi te kompresorët është i domosdoshëm. Rregullimi mund të bëhet në dy mënyra:

1. *Me ndërprerjen e motorit i cili e vë në lëvizje kompresorin, kurse më këtë edhe ndërprerjen e kompresorit*
2. *Me hedhjen e kompresorit që të punoj me ecje të zbrazët*

### 5.6.1 RREGULLIMI ME NDËRPRERJEN E KOMPRESORIT




Fig. 5.21 Rregullimi me ç'kyçjen e motorit

Kompresori 12 është vënë në lëvizje nga elektromotori 11. Kompresori thithë ajër nga atmosfera, e kompreson atë dhe e shtyp në rezervuarin 8. Nga rezervuari nëpërmjet valvolit 6 ajri shkon drejt konsumuesit. Me vdhën 1 dhe spiralen 2 krijohet vlera e dëshiruar e presionit të instalimit. Me to zhvendoset pozita e levës 3 dhe hapja e valvolit 6. Nëse zvogëlohet konsumi i ajrit pastaj rritet presioni nga ana e poshtme e membranës 4, dhe ajo së bashku me levën vertikale 5 lëviz lartë, lëviz levë 3 dhe e mbyll valvolin 6. Me këtë zvogëlohet sasia e ajrit e cila shkon drejt konsumuesit. Megjithatë, rritet presioni i ajrit në rezervuarin 8. Barku elastik 9 zgjerohet, e shtyp ndërprerësin 10 te poshtë dhe e shkyç qarkun elektrik. Elektromotori 11 pushon të punoj, ndërsa me këtë pushon të punoj edhe kompresori 12. Kur presioni do të zvogëlohet, barku elastik do të mblidhet, do të kyçet qarku elektrik dhe kompresori do të filloj të punoj. Mbrojtja e sistemit nga shkatërrimet e ndryshme është e siguruar me valvolin sigurues 7.

## **5.6.2 RREGULLIMI ME HEDHJE TË KOMPRESORIT NË ECJE TË ZBRAZËT**

Kur zbatohet mënyra e këtillë e rregullimit sistemi ka valvol, i cili gjendet ndërmjet kompresorit dhe rezervuarit. Kur zvogëlohet konsumi i ajrit atëherë kemi rritje të presionit në rezervuar. Rregulatori e hap valvolin dhe teprica e ajrit del në atmosferë. Atëherë kompresori punon në ecje të zbrazët. Kur presioni në rezervuar do të zvogëlohet valvoli mbyllët dhe sistemi vazhdon me punë normale.

### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Në çfarë mënyre mund të kryhet rregullimi i kompresorëve?
2. Shpjego mënyrat e rregullimit të kompresorëve?

### **MBAJE MEND (REZYME)**

Për zhvillim normal të proceseve në instalimet e ndryshme është i nevojshëm rregullacion i pjesëve të instalimeve.

Rregullacioni dhe instalimet e kazanëve bëhen me qëllim që të ruhet presioni dhe temperatura e avullit në vlerat e këruara. Për realizimin dhe instalimin e këtij qëllimi funksionojnë më shumë rrethe të rregullacionit me të cilat rregullohet mbushja e ujit, temperatura e avullit, ndezja dhe presioni.

Rregullacioni te turbinat me avull ka për detyrë që forcën e turbinës ta adaptoj ndaj ngarkimeve të jashtme dhe me këtë të mundësoj numrin konstant të rrrotullimeve në turbinë. Rregullacioni mund të zbatohet me ndryshimin e sasisë së avullit, me ngulfatje dhe atë të kombinuar. Më shpesh kryhet me rregulator centrifugal: direkt pa përdorimin e energjisë ndihmëse, për trupa të vegjël, ose në mënyrë indirekte me shfrytëzimin e energjisë plotësuese për trupa më të mëdhenj.

Rregullacioni i turbinave të ujit ka për qëllim ta mbajë konstant numrin e rrrotullimeve në turbinë gjatë ngarkimeve të ndryshme, kjo arrihet me ndryshimin e rrjedhjes së ujit kur vjen në turbinë. Te turbina e Peltenovit rregullimi bëhet me rruajtjen e gjilpërës në reaktiv dhe rruajtjen në uror të reaktivit me çka rregullohet rrjedhja e ujit e cila vjen në turbinë. Te turbina e Kaplenovit rregullacioni bëhet me lëvizjen e fletëve në rotor dhe lopatave në stator, kurse te turbina e Fransisovit ruhen lopatat përcjellëse të statorit.

Te turbinat e gazit rregullacioni bëhet me qëllim që të mbahet numri konstant i rrrotullimeve në boshtin e turbinës. Te turbinat e qarkut të hapur rregullacioni mund të bëhet në më shumë mënyra: me ndryshimin e sasisë së lëndës djegëse, me ngulfatjen e ajrit para hyrjes së dhomëzës për djegie dhe me lëshimin e gazrave në atmosferë. Te turbinat e qarkut të hapur fluidi punues ripërtërihet, ndërsa turbinat e qarkut të mbyllur punojnë me sasinë e njëjtë të fluidit punues.

Meqenëse gjatë eksplotimit lajmërohet nevoja që pompa të jep sasi të ndryshme të lëngut, atëherë te pompat rregullohet rrjedhja që e jep vet pompa. Rregullacioni mund të jetë me ndryshimin e numrit të rrotullimeve dhe me ngulfatje.

Te kompresorët rregullacioni është i domosdoshëm sepse konsumi i ajrit është i paparashikueshëm. Rregullacioni mund të jetë me ndërprerjen e motorit i cili e vë në lëvizje kompresorin, ndërsa me këtë edhe të ndërpritet kompresori, ose me hedhjen e kompresorit të punoj në ecje të zbrazët. Me rregullimin e kompresorit deri te konsumuesit do të vijë sasi e ndryshme e ajrit.

## 6 AUTOMATIKA NË SISTEMET E RREGULLIMIT

### 6.1. KONTROLLI AUTOMATIK

Në proceset teknologjike janë të nevojshme që karakteristikat më të rëndësishme të procesit të mbahen në kufijtë e së lejuarës, për t'u siguruar kualitet i procesit të përgjithshëm të prodhimit. Kjo arrihet me kontrollimin automatik gjatë të cilit maten madhësitë e procesit pa pjesëmarjen e njeriut, me kontrollimin automatik pengohen ndryshimet e padëshiruara dhe çrregullimi i procesit, me çka rritet kualiteti në prodhim. Kontrollimi automatik është i domosdoshëm në çdo proces.

Ai punon në bazë të parimit të rregullacionit, përkatesisht të krahasimit të madhësisë së këruar hyrëse (madhësisë së dhënë) dhe madhësisë dalëse (madhësisë së realizuar). Madhësitë të cilat kontrollohen mund të jenë dimensione ose madhësi të procesit (presion, temperaturë, niveli i lëngut dhe të tjera). Kontrollimi automatik mund të jetë:

1. Sipas mënyrës së veprimit – ***pasiv dhe aktiv***
2. Sipas mënyrës së matjes së madhësive – ***me matje direkte dhe me matje indirekte***

#### 6.1.1 KONTROLLIMI AUTOMATIK PASIV DHE AKTIV

Me kontrollimin pasiv regjistrohet arritura e kufijve maksimalë të lejuar të shhangies së madhësive karakteristike në proces. Kur në proces do të arrihen ato kufij formohen sinjale të drithës ose zërit, me të cilat lajmërohet tejkalimi i shhangieve të lejuara. Është karakteristike ajo, që kjo kontroll kryhet pas rrjedhjes së procesit teknologjik. Në llojin e veçantë të kontrollit pasiv bëjnë pjesë edhe mënyrat e ndarjes (dallimit) të objekteve mirë të punuara dhe keq të punuara (si për shembull trupat e drejtpërdrejtë te shtretërit me rrota).

Për kontrollimin pasiv është karakteristike ajo që rezultatet e saj nuk ndikojnë në mënyrë automatike në procesin teknologjik. Së pari patjetër të lajmërohet ndonjë sinjal si rezultat i kontrollimit, kurse pastaj të veprohet. Kontrollimi pasiv nuk ka korreksion automatik të gabimeve. Shembull:




Fig. 6.1. Kontrollimi pasiv

Bëhet kontrollimi i diametrave të trupave të drejtpërdrejtë 1 me shtretërit me rrota. Matësi zhvendoset në diametrin e kërkuar. Nëse diametri i trupit të drejtpërdrejtë është më i madh nga i kërkuarit, leva çohet, kyçet kontakti 3 dhe ndizet drita e verdhë. Ai trup i drejtpërdrejtë shkon në përpunim. Nëse diametri i trupit të drejtpërdrejtë është më i vogël prej të kërkuarit, leva 2 lëviz te poshtë, kyçet kontakti 4 dhe ndizet drita e kuqe. Trupi i tillë i drejtpërdrejtë dërgohet në vend tjetër sepse nuk mund të përpunohet.

Me kontrollimin aktiv automatik vazhdimisht përcillet procesi teknologjik dhe madhësitë në të. Nëse lajmërohet sinjali për shmangje të ndonjë madhësie nga vlera e tij kërkuar, menjëherë veprohet që ajo madhësi të korrigohet dhe të sillet në vlerën e saj të kërkuar. Kontrollimi aktiv zbatohet gjatë procesit teknologjik. Shembull:





Fig. 6.2 Kontrollimi aktiv

Pjesa 1 përpunohet në zdrukth me thikën 2 që të zvogëlohet diametri i tij. Diametri i trupit vazhdimesht matet me matës elektrik 3. Kontakti 5 është i zhvendosur në kufirin e lartë të lejuar, kure kontakti 6 në kufirin e poshtëm të lejuar të shhangies së diametrit të trupit. Nëse diametri i trupit është më i madh nëpërmjet levës 4 do të kyçet kontakti 5 i cili dërgon sinjal në përforcuesin i cili po ashtu do të dërgon sinjal deri te rregullatori, ndërsa ai do të veproj mbi organin ekzekutiv që thika të zhvendoset përpara për vlerën e gabimit. Nëse diametri i trupit është më i vogël kyçet kontakti 6. Atëherë rregullatori dërgon sinjal deri te organi ekzekutiv dhe thika tërhiqet për vlerën e caktuar sa është edhe gabimi.

### 6.1.2 KONTROLLIMI AUTOMATIK ME MATJE DIREKTE DHE INDIREKTE

Te sistemet me kontrollim automatik me matje direkte, elementi matës direkt e matë madhësinë e procesit i cili kontrollohet.



*Fig. 6.3. Kontrollimi me matje direkte*

Në figurën 6.3 është dhënë shembull për kontrollimin automatik me matje direkte ku kontrollohet temperatura e fluidit në dhomëzën 1. Elementi matës është vendosur në fluid, ai jep informacion për temperaturën e fluidit drejtpërdrejtë nga vendi ku ajo temperaturë formohet. Në varshmëri prej temperaturës leva 4 ose afrohet ose largohet nga reaktivi 3. Me zbatimin e distancës h ndryshon edhe rrjedhja e ajrit, përkatësisht presioni i ajrit në përcjellësin pneumatik. Nëpërmjet ndryshimit të shtypjes fitohet informacion për ndryshimin e temperaturës në fluid të dhomëzës.

Te sistemet e kontrollimit automatik me matje indirekte, elementet matëse nuk janë në kontakt të drejtpërdrejtë me madhësitë të cilat kontrollohen. Ato janë të lidhura me disa madhësi të tjera nëpërmjet të cilave fitojnë informacion për madhësinë e kontrolluar.




Fig. 6.4 Kontrollimi me matje indirekte

Nëse kontrollohet përpunimi i lugut nuk është e mundur që direkt të maten dimensionet e rëndësishme të procesit. Patjetër të shfrytëzohet kontrolli me matje indirekte. Shembulli i dhënë në figurë i boshtit të përdredhur bën zhvendosje drejtvizore të objektit të përpunuar. Matet numri i rrotullimeve i të përdredhurës i cili pastaj shndërrohet në gjatësi. Informacioni i shndërruar në signal elektrik përcillet deri tek përcuesi ku krahasohet me madhësinë e dhënë. Dallimi i cili vërtetohet në këtë mënyrë jep informacion për dimensionet e lugut gjatë përpunimit.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Pse është e domosdoshme që secili proces të ketë kontrollim automatik?
2. Në bazë të çfarë parimi vepron kontrollimi automatik?
3. Çfarë mund të jetë kontrollimi automatik?
4. Shpjego dallimin ndërmjet kontrollimit automatik pasiv dhe aktiv?
1. 5 Shpjego dallimin e kontrollimit automatik me matje direkte dhe indirekte?

## 6.2. SINJALIZIMI

Te instalimet e përbëra sistemi i sinjalizimit përfshin më shumë procese. Që të mundësoj përcjellje të madhësive në të gjitha proceset, është e domosdoshme që të mblidhen sinjale për të gjitha në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Kjo i mundëson udhëheqësit ta përcjell procesin. Për këtë shkak pajisjet sinjalizuese duhet t'i plotësojnë kërkesat vijuese:

1. Çdo ndryshim i madhësive të jetë lehtë i dukshëm.
2. Sinjali saktë të tregon se cila madhësi është ndryshuar dhe a thua ajo madhësi është zmadhuar ose zvogëluar.

Sinjalizimi mund të jetë:

**1. I kontinuar(i vazhdueshëm)** – me këtë lloj të sinjalizimit udhëheqësi i procesit në çdo kohë ka informacion për vlerën momentale të madhësive në proces.

**2. I përkohshëm** – Para instrumentit ka ndërprerës me të cilin udhëheqësi e zgjedh madhësinë të cilën dëshiron ta përcjell në instrument. Ky sinjalizim përdoret kur një madhësi matet në më shumë vende ose kur ekziston lidhshmëri e madhësive në proces. Atëherë udhëheqësi madhësinë më kritike e përcjellë në mënyrë të vazhdueshme, kurse madhësitë e tjera në proces i përcjell kohë pas kohe.

Krahas instrumenteve vizuale sinjalizimi shfrytëzon edhe instrumente për të regjistruar, të cilët ndryshimin e madhësive e regjistrojnë në shirit. Instrumentet e këtilla mund të janë:

**1. Në përqindje** – kanë shkallë në përqindje prej 0% deri më 100%. Më shpesh përdoren për tregimin e hapjeve të valvolave, mbushjen e rezervuarëve dhe të tjera.

**2. Absolute** - shirit në të cilin regjistrohet shkalla në njësi matëse e cila varet prej madhësisë e cila përcillet. Madhësitë të cilat më shpesh përdoren me instrumente të këtilla janë: presioni, temperatura, rrjedhja dhe të tjera.

Regjistrimi në shirit mund të jetë:

**1. I kontinuar(i vazhdueshëm)** – zbatohet për madhësi të cilat shpejt ndryshojnë. Ndryshimet regjistrohen në shirit me shkallë përkatëse. Ekzistojnë edhe instrumente te të cilët në të njëjtin shirit regjistrohen më shumë madhësi.

**2. Me kapërcime** – zbatohet për madhësi të cilat maten në më shumë vende. Fitohet dhe regjistrohet sinjali nga vendi i parë matës, pastaj nga vendi i dytë matës dhe kështu me radhë deri te vendi i fundit matës. Pas ndonjë intervali kohor cikli përsëritet.

Në varshmëri prej ndryshimit të madhësive në proces, të cilët përcillen mund të shfrytëzohen instrumente të shpejta dhe të ngadalshme për regjistrim. Shpejtësinë e instrumenteve mund të ndryshoj udhëheqësi i procesit kur pret ndryshim të shpejtë dhe dëshiron që atë ta regjistroj.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cila është rëndësia e sinjalizimit në proces?
2. Çka duhet të mundësojnë pajisjet sinjalizuese?
3. Çfarë mund të jetë sinjalizimi?
4. Çfarë instrumente përdoren për sinjalizim?

### 6.3 UDHËHEQJA

Udhëheqja e proceseve mund të jetë: **automatike, gjysmë automatike dhe me dorë**.

**1. Udhëheqja automatike** – Te ky lloj i udhëheqjes përdoret kompjuteri. Në kompjuter është përpunuar program me orar kohor dhe me radhitje të aktiviteteve, të pjesëve të instalimeve të cilat sigurojnë udhëheqje të drejtë të procesit. Kompjuteri i përcjell të gjitha pjesët e instalimit dhe nëse ndodhë

çfarëdo qoftë shmangie nga programi, kompjuteri e ndërpret programin dhe jep sinjal për problemin. Udhëheqësi i procesit duhet ta mënjanoj problemin dhe përsëri ta aktivizoj programin.

**2. *Udhëheqja gjysmë automatike*** – Te ky lloj i udhëheqjes është e nevojshme të kontrollohet pozita e valvolave, të sigurohet fluidi i punës në hyrje të instalimit dhe t'i ketë parametrat e kërkuar (presionin, temperaturën dhe të tjera), të kontrollohet a janë kyçur pajisjet për mbrojtje, të sigurohet radhitja e kyçjes dhe ndërprerjes së pjesëve të caktuara të ngrehinës(instalimeve) dhe të tjera. Në rastin e problemit konkret udhëheqësi i procesit, ose kompjuteri, japid sinjal për kyçjen ose ndërprerjen e ndonjë pjese më të përbërë të ngrehinës.

**3. *Udhëheqja me dorë*** - Udhëheqësi i procesit, ose grupi i udhëheqësve, pas pranimit të sinjalit për problemin e caktuar vijnë deri te ndërprerësi, valvoli ose organi tjeter ekzekutiv. Kjo është vështirë e zbatueshme posaçërisht tek instalimet e ndërlikuara. Për shkak të kësaj komandat për të gjitha pajisjet më vitale sillen në tabelën komanduese dhe në këtë mënyrë një udhëheqës mund të menaxhoj me gjithë procesin.

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Çfarë mund të jetë udhëheqja me proceset?
2. Cili është dallimi ndërmjet udhëheqjes automatike, gjysmë automatike dhe me dorë e proceseve?

#### 6.4. TABELA KOMANDUESE ME INSTRUMENTET

Që të mund proceset e ndërlikuara të përcjellin të gjitha pajisjet për sinjalizim, patjetër të vendosen në tabelën e komandës së përbashkët. Ajo duhet të jetë e dukshme që të mund udhëheqësi i procesit me kohë ta vështroj sinjalin për ndryshim të ndonjë madhësie në proces dhe të reagoj për largimin e problemit.

Të gjitha pajisjet për sinjalizim dhe udhëheqje janë të vendosura në sallën komanduese. Për shkak të sigurimit të punës së sigurt të instrumenteve në sallën komanduese patjetër të mbahet temperatura dhe lagështia konstante. Kjo hapësirë është e klimatizuar dhe siguron punë të papenguar të instrumenteve dhe koncentrimin e pazvogëluar të udhëheqësit.

Tabelat komanduese patjetër të janë të kontrolluara dhe instrumentet në to të janë lehtë të dukshme. Pajisjet për udhëheqje dhe me pjesë posaçërisht të rëndësishme të fabrikës, janë të theksuara dhe mbrojtura për të mos ardhur rastësisht deri te aktivizimi i tyre. Në këtë mënyrë mundësohet një siguri gjatë udhëheqjes me instrumente.

Krahas tabelës komanduese ekziston edhe skema e fabrikës në të cilën ka ditë e cila tregon fillim dhe fund të ndonjë procesi. Në këtë mënyrë udhëheqësi në çdo kohë është i njofuar për gjendjen e çdo pjese të fabrikës, (shembull a

është pompa e kyçur ose e ndërprerë, valvoli a është i mbyllur ose i hapur dhe të ngjashme).

Në sallat komanduese bashkëkohore ekzistojnë edhe pajisje për përcjelljen plotësuese të procesit. Sallat e tillë kanë ekrane. Nëpër fabrika janë të vendosura kamera, zakonisht në vende të paprekshme, vende të ndotura, vende me temperaturë të lartë, që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut. Me zgjidhjen e kamerës udhëheqësi mund t'i përcjellë vendet e tillë.

Te fabrikat bashkëkohore me pajisje bashkëkohore sinjalizuese dhe ku udhëheqja bëhet me kompjuter, vetë kompjuteri jep komandë të caktuar dhe madhësitë i sjellë në vlerat e këruara. Në proceset e tillë valvolin e përcjell procesi që të mund të veproj në rast të avarisë(shkatërrimit).

#### PYETJE DHE DETYRA:

1. Cila është rëndësia e tabelës komanduese në proceset e ndërlikuara?
2. Çfarë pajisjesh përdoren për përcjelljen e proceseve të ndërlikuara?

### 6.5 MBROJTJA (BLLOKADA)

Ndryshimi i madhësive të proceseve përcillet me ndihmën e sinjalizimit. Kur ndryshimet e madhësive ndodhin shumë shpejtë, nuk është e mjaftueshme vetë të vërehet ndryshimi i madhësisë, por është e domosdoshme shpejtë të reagohet që të mbrohet objekti. Për atë proceset sigurohen ashtu që madhësitë nuk guxojnë t'i kalojnë kufijtë e lejuar. Krahas pajisjeve sinjalizuese të cilat njoftojnë se ka ndodhur ndryshim në madhësitë, kyçen edhe pajisjet posaçërisht të vendosura në fabrikë të cilat pengojnë ndryshimin e mëtutjeshëm të madhësive. Pajisjet e tillë mund të janë: **ndihmëse, të domosdoshme dhe të avarisë**.

Sinjalizimi i cili tregon për gjendjen e jashtëzakonshme (kritike) vendoset pavarësisht nga sinjalizimi për ndryshimin e madhësive në proces në regjimin nominal. Kjo zbatohet për shkak të sigurisë më të madhe të fabrikës dhe sinjalit për gjendjen e jashtëzakonshme me siguri që të arrijë deri te vendi i caktuar: të aktivizoj ndonjë pajisje ose vetëm ta lajmëroj udhëheqësin e procesit.

**Pajisjet ndihmëse** kanë për detyrë kur ndonjë madhësi në proces bie, atëherë atë ta rrisin. Shembull kur presioni në fluidin e punës nga çfarëdo shkaku bie kyçet pompa ndihmëse e cila përpinqet që presionin ta mbajë në kufijtë e së lejuarës. Nëse presioni edhe më tutje bie dhe e arrin kufirin në mënyrë minimale të lejuar, kyçet pompa e domosdoshme. **Pajisjet e domosdoshme** kyçen kur do të arrihet kufiri në mënyrë të lejuar minimale të madhësive.

**Pajisjet e avarive** kyçen kur vlera e madhësive është nën kufirin minimal të lejuar. Kanë për detyrë që në mënyrë të sigurt ta ndalin fabrikën dhe t'i pengojnë dëmet që mund të ndodhin.

Pajisjet e avarive janë të pavarura nga matja dhe sinjalizimi i procesit. Te mbrojtja posaçërisht e rëndësishme, ku kanë për detyrë të pengojnë avari, pajisjet e këtilla zbatohen ashtu që të mund të reagojnë pa matje, pa përcjelljen e sinjalit dhe nevojës për energji plotësuese. Për shembull: gjatë zmadhimit të presionit aktivizohen valvolat e sigurisë, gjatë zmadhimit të numrit të rrrotullimeve aktivizohen rregullatorët e sigurisë dhe të ngashme.

#### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Çfarë pajisjesh përdoren për mbrojtjen e proceseve të sistemit?
2. Kur veprojnë pajisjet për mbrojtje dhe cila është detyra e tyre?

### **6.6 PËRDORIMI I KOMPJUTERIT NË SISTEMET E UDHËHEQJES**

Që të mund procesi të udhëhiqet me kompjuter është e nevojshme që kompjuteri të përbaj programin përkatës.

Programi i kompjuterit përmban më shumë operacione të cilat shfrytëzohen për zgjedhjen e problemit konkret. Gjatë zgjidhjes së problemit me kompjuter është e nevojshme të bëhet:

- identifikimi i problemit
- përpunimi i modelit matematik për problemin konkret
- formimin e algoritmit i cili paraqet renditje të operacioneve sipas të cilit do të zgjidhet problemi konkret
- zgjedhje e numrit minimal të operacioneve për zgjidhjen e problemit

Kur do të kryhen operacionet, programi kontrollohet dhe bëhet korrekioni i tij në qoftë se ai është i nevojshëm. Vërtetohet zgjidhja përfundimtare për problemin.

Ekzistojnë dy mënyra themelore për udhëheqjen e proceseve të ndërlikuara:

#### ***Udhëheqja e drejtpërdrejtë dhe indirekte.***

Gjatë ***udhëheqjes*** së ***drejtpërdrejtë*** kompjuteri dhe objekti nuk janë drejtpërdrejtë të lidhur. Ato janë të lidhur me pjesëmarrjen e njeriut. Roli i kompjuterit është të mbajë mend numër më të madh të informacioneve dhe të bëj analizën e të dhënavë të cilat janë të nevojshme për njeriun.

Te proceset e ndërlikuara mënyra e këtillë e udhëheqjes nuk mund të jetë e kënaqshme. Tek ato aplikohet ***udhëheqja e drejtpërdrejtë*** ku kompjuteri është drejtpërdrejtë i lidhur me objektin dhe pranon informacion kthyes për madhësinë dalëse të objektit. Njeriu e mbanë të drejtën ta ndryshojë vlerën e kërkuar të madhësive në proces.

Gjatë udhëheqjes së proceseve të ndërlikuara me kompjuter përdoren simbole analoge dhe digitale. Sistemi ka ***udhëheqje analoge*** nëse përpunohej dhe përcillej informacione në mënyrë të pandërprerë. Nëse

informacionet përpunohen dhe përcillen me ndërprerje, në intervale të caktuara kohore, udhëheqja është ***digjitale***. Ekziston edhe ***udhëheqja hibride*** e proceseve që përmban edhe elemente analoge edhe digjitale.

Karakteristikë e rëndësishme e kompjuterëve është që të jenë në çdo moment të gatshëm të reagojnë në ndonjë ndryshim në proces. Nëse ndodh ndryshim në ndonjë madhësi në proces, kompjuteri kyç program të caktuar i cili e përpunon situatën e krijuar. Meqenëse mundësitë e kompjuterit janë të mëdha, ato përdoren për përcjelljen e më shumë madhësive në proces dhe në këtë mënyrë udhëheq me më shumë madhësi. Kompjuteri në mënyrë automatike i mbledh të dhënat, i përcjell sinjalat nga instrumentet matëse deri te kompjuteri dhe drejtpërdrejtë udhëheq(menaxhon). Gjatë veprimit të tillë të kompjuterit në procese është i domosdoshëm komunikimi ndërmjet njeriut (udhëheqësit të procesit) dhe kompjuterit.

Me përdorimin e kompjuterëve shumë është lehtesar përcjellja e proceseve të ndërlikuara dhe udhëheqja me to.

#### **PYETJE DHE DETYRA:**

1. Cili është roli i kompjuterit në udhëheqjen e proceseve?
2. Çfarë mund të jetë udhëheqja e proceseve me kompjuter?

#### **MBAJE MEND (REZYME):**

Që të sigurohet kualitet i proceseve, dhe përgjithësisht i prodhimit, është i domosdoshëm që çdo proces të ketë kontrollim automatik të madhësive ose dimensioneve të cilat zhvillohen pa pjesëmarrjen e njeriut.

Kontrollimi automatik mund të jetë:

1. Sipas mënyrës së veprimit – ***pasiv dhe aktiv***
2. Sipas mënyrës së matjes së madhësive – ***me matje direkte dhe me matje indirekte***

Kontrollimi pasiv zbatohet pas mbarimit të procesit teknologjik dhe rezultatet e tij nuk ndikojnë në mënyrë automatike në procesin teknologjik. Kontrollimi aktiv kryhet gjatë procesit teknologjik dhe madhësitë e tyre sillen deri te vlera e tyre e kërkuar.

Gjatë kontrollimit me matje direkte elementi matës drejtpërdrejtë e matë madhësinë e cila kontrollohet. Gjatë kontrollimit me matje indirekte informacioni për madhësinë e kontrolluar fitohet me matje të lartësisë tjeter e cila është e lidhur me lartësinë e kontrolluar.

Që të mundësohet përcjellja e proceseve është e domosdoshme që në fabrika të ekzistoj sinjalizimi i cili përdor **instrumente vizuale** dhe **instrumente për regjistrim**. Sinjalizimi mund të jetë: *i kontinuar(i vazhdueshëm) dhe i përkohshëm*. Instrumentet mund t'i regjistrojnë madhësitë vazhdimesh ose me kapërcime të shiritit i cili ka njësi matëse për madhësinë përcjellëse ose përqindjen. Të gjitha pajisjet për sinjalizim vendosen në tabelën komanduese e cila vendoset në sallën komanduese të fabrikës. Kur ndryshimet e madhësive ndodhin shumë shpejt për mbrojtjen e fabrikës përdoren **pajisje ndihmëse, të domosdoshme dhe të avarive** të cilat janë të vendosura nëpër fabrikë.

Udhëheqja e proceseve mund të jetë: **automatike, gjysmë automatike dhe me dorë**. Gjatë udhëheqjes automatike përdoret kompjuteri i cili mund të jetë direkt i lidhur me objektin (**udhëheqja e drejtpërdrejtë**) ose lidhja e kompjuterit dhe objektit të jetë indirekte (**udhëheqje indirekte**) me pjesëmarrjen e njeriut. Informacionet mund të përcillen pandërprerë (**udhëheqje analoge**) ose me ndërprerje (**udhëheqje digitale**). Ekziston edhe **udhëheqja hibride** e proceseve që përmban edhe elemente analoge edhe elemente digitale.

# PËRMBAJTJA

Parathënie	3
Hyrje	5
1. NOCIONET THEMELORE TË SISTEMEVE	7
1.1 Nocioni për sistemet	7
1.2. Elementet hyrëse dhe dalëse	8
1.3. Objekti dhe çrregullimet	10
1.4. Sistemi për udhëheqje	11
1.5. Sistemi i udhëheqjes automatike dhe përparësitë e tij	13
1.6. Llojet e sistemeve të udhëheqjes automatike	14
1.7. Shembuj të sistemeve të udhëheqjes automatike	17
Mbaje mend (rezyme)	20
2. LIDHJET THEMELORE TË SISTEMEVE	21
2.1. Lidhja rendore e sistemeve	21
2.2. Lidhja paralele e sistemeve	21
2.3 Lidhja kthyese e sistemeve	22
2.4. Funksioni përcjellës i sistemeve	24
2.5. Bllok diagrami ekuivalent dhe funksioni i lidhjes përcjellëse	26
2.6. Bllok diagrami ekuivalent dhe funksioni përcjellës i lidhjes paralele	28
2.7. Bllok diagrami ekuivalent dhe funksioni përcjellës i lidhjes kthyese	29
Mbaje mend (rezyme)	31
3. STRUKTURA E SISTEMEVE TË RREGULLIMIT	33
3.1. Sistemet e rregullimit	34
3.2. Organet e sistemit të rregullimit	35
3.3. Rregulatorët	36
3.3.1. Rregulatorët – llojet dhe ndarjet	36
3.3.2. Rregulatorët me veprim direkt dhe indirekt	37
3.3.3. Llojet e rregulatorëve sipas karakteristikave të veprimit të rregulatorit	40
3.4. Dhënësit	41
3.5 Elementet matëse	43
3.5.1. Elementet matëse për presion	43
3.5.2. Elementet matëse për rrjedhje	44
3.5.3. Elementet matëse për nivelin e lëngut	45
3.5.4. Elementet matëse për temperaturën	46
3.6. Përforcuesit	47
3.7. Shndërruesit	49
3.8. Krahasuesit	50
3.9. Elementet ekzekutive	51
Mbaje mend (rezyme)	53

<b>4. RREGULLIMI I MADHËSIVE TË PROCESIT</b>	<b>54</b>
4.1. Rregullimi i presionit	54
4.2. Rregullimi i rrjedhjes	55
4.3. Rregullimi i nivelit të lëngut	56
4.4. Rregullimi i temperaturës	58
4.5. Rregullimi i sasisë së lëndës djegëse	60
Mbaje mend (rezyme)	61
<b>5. RREGULLIMI I INSTALIMEVE</b>	<b>62</b>
5.1. Rregullimi i kazanëve dhe instalimet e kazanëve	62
5.1.1. Rregullimi i mbushjes së ujit	62
5.1.2. Rregullimi i temperaturës së avullit	64
5.1.3. Rregullimi i ndezjes	65
5.1.4. Rregullimi i presionit në ndezjet	67
5.2. Rregullimi i turbinave të avullit	68
5.2.1. Rregullimi direkt dhe indirekt te turbinat e avullit	72
5.3. Rregullimi i turbinave të ujit	73
5.3.1. Rregullimi te turbinat e Peltonovit	73
5.3.2. Rregullimi te turbinat e Kapllanovit	74
5.3.3. Rregullimi te turbinat e Fransisovit	75
5.4. Rregullimi i turbinave të gazta	76
5.4.1. Rregullimi i turbinave të gazit në qarkun e hapur	76
5.4.2. Rregullimi i turbinave të gazit në qarkun e mbyllur	78
5.5. Rregullimi i pompave	79
5.5.1. Rregullimi i pompave me ndryshimin numrit të rrotullimeve	79
5.5.2 Rregullimi i pompave me ngulfatje	80
5.6. Rregullimi i kompresorëve	81
5.6.1. Rregullimi me ndërprerjen e kompresorit	81
5.6.2. Rregullimi me hedhje të kompresorit në ecje të zbrazët	82
Mbaje mend (rezyme)	82
<b>6. AUTOMATIKA NË SISTEMET E RREGULLIMIT</b>	<b>84</b>
6.1. Kontrollimi automatik	84
6.1.1. Kontrollimi aktiv dhe pasiv	84
6.1.2. Kontrollimi automatik me matje direkte dhe indirekte	84
6.2. Sinjalizimi	86
6.3. Udhëheqja	87
6.4. Tabela komanduese	88
6.5. Mbrojtja (bllokimi)	89
6.6. Aplikimi i kompjuterëve në sistemin e udhëheqjes	90
Mbaje mend (rezyme)	92
Literatura e shfrytëzuar	96

## **Literatura e shfrytëzuar**

1. Вукосављевић Бранко и М-р Марјановић Милорад, *Основе технике мерења и аутоматизације*, Завод за уџбенике и наставна средства - Београд, 1995год.
2. Милојковић Р. Борислав и Грујић Т. Љубомир, *Аутоматско управљање*, Машински факултет - Београд, 1981год.
3. Митровић Гордана и Спасојевић Мирослав, *Аутоматизација постројења*, Завод за уџбенике и наставна средства - Београд, 1990год.
4. В.Максимовски,М.Серафимовски,К.Димитров,М.Димитровски,А.Блажевски *Термодинамика и термотехника*, Просветно дело-Скопје, 1992год.
5. Д-р Методија Мирчевски, *Хидраулика со хидраулични машини- 2*, Просветно дело, 1981год.